



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.205

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 045 datë 24.12.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së transferimit dhe kontributit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondacionit për Financimin dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve (FEFAD) dhe Fondit European për Europën Juglindore (EFSE)”.....	11035
Ligj nr.10 046 datë 24.12.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë dhe të projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KFW) për financimin e projektit “Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza, Korça IV””.....	11045
Ligj nr.10 051 datë 29.12.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	11054
Ligj nr.10 052 datë 29.12.2008	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	11065
Ligj nr.10 053 datë 29.12.2008	Për një shtesë në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	11075
Ligj nr.10 054 datë 29.12.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	11076

LIGJ
Nr.10 045, datë 24.12.2008

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË TRANSFERIMIT DHE KONTRIBUTIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE, FONDACIONIT PËR FINANCIMIN DHE ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE
(FEFAD) DHE FONDIT EUROPIAN PËR EUROPËN JUGLINDORE (EFSE)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e transferimit dhe kontributit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondacionit për Financimin dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve (FEFAD) dhe Fondit Europian për Europën Juglindore (EFSE)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.6002, datë 13.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE TRANSFERIMI DHE KONTRIBUTI
NDËRMJET FONDACIONIT PËR FINANCIMIN DHE ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE
(FEFAD) SI TRANSFERUESI, REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE, SI AKSIONAR I ARDHSHËM DHE FONDIT EUROPIAN PËR
EUROPËN JUGLINDORE SA, SICAV-SIF (EFSE), SI PËRFITUES

Preambulë

A. FEFAD (Fondacioni për Financimin dhe Zhvillimin e Ndërmarrjeve) u themelua në vitin 1995 si rezultat i bashkëpunimit financiar shqiptaro-german. Objektivat e tij kryesorë ishin projektimi, zbatimi dhe nxitja e masave për zhvillimin e sektorit financiar, për të siguruar financim në kushtet e tregut për ndërmarrjet tepër të vogla, të vogla dhe të mesme në sektorin tregtar në Shqipëri dhe për të kontribuar në zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Fondacioni nuk u ka dhënë drejtpërdrejt hua ndërmarrjeve tepër të vogla dhe SME-ve, por i ka dhëna hua këto fonde nëpërmjet institucioneve të kualifikuara financiare, si bankat e licencuara, OJQ-të kredihënëse, shoqatave të kursimeve dhe kredive etj.

B. KfW-ja i ka dhënë dy hua Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave (këtu e quajtur Aksionari i Ardhshëm) që i ka dhënë pjesë të fondeve FEFAD-it si fonde të tij fillestare. Pjesa tjetër e huave të dhëna nga KfW-ja i është dhënë FEFAD-it nga Aksionari i Ardhshëm. Aksionari i Ardhshëm mund të dëshirojë që programet e ardhshme për SME-të të zbatohen nga EFSE-ja, duke përfshirë një projekt të bashkëpunimit financiar që është rënë dakord ndërmjet Qeverisë Gjermane dhe Shqiptare dhe që është në faza të përparuara të bisedimeve.

C. Pas më shumë se një dekadë ekzistencë për FEFAD-in dhe me qëllim përthithjen e më shumë burimeve financiare të dedikuara për mbështetjen e zhvillimit të ekonomisë shqiptare, KfW-ja dhe Aksionari i Ardhshëm kanë rënë dakord për të likuiduar FEFAD-in dhe t’ia transferojnë sendet pasurore të FEFAD-it EFSE-s.

D. EFSE është një fond investimesh nga Luksemburgu në formën e një Sicav-i (Shoqëri Investimesh me Kapital të Ndryshueshëm) që është themeluar më 15 dhjetor 2005. Objektivi i tij është sigurimi i financimit për zhvillimin, tashmë kryesisht hua, në rajonin e Europës Juglindore, nëpërmjet sektorit financiar lokal, duke u përqendruar kryesisht te nevojat e ndërmarrjeve tepër të vogla, të vogla dhe të mesme dhe ekonomive shtëpiake private.

E. Fondet fillestare të EFSE-s rrjedhin prej fondeve financiare të njëpasnjëshme që u themeluan në Bosnjë-Hercegovinë, Serbi, Mal i Zi dhe Kosovë qysh prej vitit 1998. Këto fonde të njëpasnjëshme u caktuan, nëpërmjet kontributeve në natyrë dhe në para, tek aksionet C të nënfondeve Kombëtare përkatëse të Përfituesit.

F. Po ashtu sendet pasurore të FEFAD-it jepen për llogari të Aksionarit të Ardhshëm si kontribues i aksioneve C të një nënfondi të ri kombëtar C brenda Përfituesit, nënfondi C i Shqipërisë. Menjëherë pasi të jetë kryer transferimi i sendeve pasurore të FEFAD-it tek EFSE dhe transferimi i aksioneve C tek Aksionari i Ardhshëm në ngjarjen e fillimit, FAFAD-i në bashkëpunim me Aksionarin e Ardhshëm kryen të gjitha veprimet e nevojshme për të likuiduar FEFAD-in sipas ligjit shqiptar.

G. FEFAD-i ka lidhur marrëveshje huaje me bankat partnere dhe OJQ-të në Shqipëri sipas parashikimit në aneksin 1. Para likuidimit të FEFAD-it, marrëveshjet e huasë i transferohen Përfituesit për llogari të Aksionarit të Ardhshëm si kontribues i aksioneve C. Pjesëmarrja në kapital që FEFAD-i kishte në Bankën ProCredit Shqipëri iu shit ProCredit Holding para likuidimit dhe mjetet monetare do t'i transferohen gjithashtu Përfituesit për llogari të Aksionarit të Ardhshëm.

H. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është rënia dakord për hollësitë e:

a) transferimit të marrëveshjeve të huasë të përmendura në aneksin 1 të ndryshuar herë pas here së bashku me çdo marrëveshje garancie dhe marrëveshje të tjera dhe dokumente që i përkasin (marrëveshjet ekzistuese) nga Transferuesi te Përfituesi për llogari të Aksionarit të Ardhshëm, ndërsa këto transferime përbëjnë kontributet në natyrë (të përkufizuar më poshtë) të Aksionarit të Ardhshëm; dhe

b) kontributit për llogari të Aksionarit të Ardhshëm nga Transferuesi te Përfituesi të shumave të caktuara në para që janë në kredinë e FEFAD-it,

ndërsa në lidhje me transferimet e përcaktuara më sipër, Aksionari i Ardhshëm merr një numër të caktuar të aksioneve C në nënfondin C Shqipëri të Përfituesit që do të përcaktohet në formularin e kontributit që gjendet në aneksin 3, që do të nënshkruhet nga Aksionari i Ardhshëm dhe EFSE.

I. Secili prej huamarrësve ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim për transferimin e marrëveshjeve përkatëse ekzistuese (pëlqimi), kopje të të cilit janë bashkëngjitur si aneksi 2.

Është rënë dakord si më poshtë:

1. Interpretimi

1.1 Përkufizime. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga pika 1.1 ose ndryshe në këtë Marrëveshje ose në anekset e saj, ose përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim që u jepet atyre në dokumentin e lëshimit të Përfituesit në fuqi në datën përkatëse.

Nenet e themelimit: Nenet e themelimit të Përfituesit që janë në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

Huamarrësi: Bankat partnere dhe OJQ-të në Shqipëri, të cilave FEFAD-i u ka dhënë hua sipas marrëveshjeve të huave të përcaktuara në aneksin 1.

Kontributi në para: Çdo shumë në para në euro që duhet të paguhet nga Transferuesi për llogari të Aksionarit të Ardhshëm dhe në përmbushje të detyrimeve të Aksionarit të Ardhshëm për të dhënë një kontribut në para për nënfondin C Shqipëri të Përfituesit sipas parashikimit në kolonën me titull “Në para” në seksionin 2 të formularit të kontributit dhe të paguar nga Transferuesi për llogari të Aksionarit të Ardhshëm Përfituesit në pajtim me pikën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Kontribut në natyrë: Të drejtat dhe detyrimet e Transferuesit sipas dhe në lidhje me marrëveshjet ekzistuese që duhet të kontribuohet nga Transferuesi për llogari të Aksionarit të Ardhshëm dhe në përmbushje të detyrimit të Aksionarit të Ardhshëm për të dhënë një kontribut në natyrë në kapitalin e nënfondit C Shqipëri të Përfituesit në një vlerë të përcaktuar në raport nga një audit i pavarur (réviseur d'entreprise agréé sipas ligjit të Luksemburgut) në lidhje me vlerësimin e të drejtave dhe detyrimeve sipas ose në lidhje me marrëveshjet ekzistuese të datës [***] dhe të barabarta me shumën e kontributit të parashikuar në kolonën me titull “Në natyrë” në seksionin 2 të formularit të

kontributit.

Ngjarja e fillimit: Nxjerrja e aksioneve C të Përfituesit në formë të regjistruar sipas neneve 6, 7 dhe 8 të neneve të themelimit të EFSE-së për Aksionarin e Ardhshëm në një shifër të përgjithshme që parashikohet në formularin e kontributit të nënshkruar nga Aksionari i Ardhshëm dhe EFSE-ja.

Likuidimi: Procesi i likuidimit i kontrolluar nga një likuidator i emëruar i gjendjes ekzistuese të subjektit ligjor FEFAD që synon të paguajë të gjithë borxhet e mbetura dhe detyrimet e tjera të subjektit juridik ndaj palëve të treta, si dhe kryerja e të gjitha veprimeve të nevojshme dhe raporteve që duhet të paraqiten për aprovim tek organi vendimmarrës i këtij subjekti ligjor deri në finalizimin e procesit të likuidimit dhe të gjitha formalitetet e duhura publikohen nga likuidatori në gazetën lokale përkatëse në pajtim me ligjin shqiptar. Në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Bordi i të Besuarve ka marrë vendimin për likuidimin. Në përgjigje të marrjes së sendeve pasurore neto nga FEFAD-i nëpërmjet EFSE-s gjatë likuidimit, Aksionari i Ardhshëm anulon të gjitha detyrimet që FEFAD-i ka ndaj tij në lidhje me dhënien e mëparshme të huave të KfW-së.

Marrëveshjet ekzistuese: Marrëveshjet ekzistuese të huasë të parashikuara në aneksin 1 siç përmendet në preambulën sipas (H).

1.2 Interpretimi: Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje ose kur konteksti e kërkon ndryshe, referencat në:

a) këtë Marrëveshje ose një marrëveshje tjetër apo dokument tjetër janë referenca në ato marrëveshje ose dokumente të tjera të ndryshuara, plotësuara ose zëvendësuara herë pas here dhe

b) personat fizikë, personat juridikë, ortakëritë ose shoqatat e paregjistruara përfshijnë çdo person fizik ose person juridik, ortakëri ose shoqëri të paregjistruar që trashëgojnë pjesërisht ose plotësisht të drejtat ose detyrimet nëpërmjet transferimit, marrjes përsipër të detyrimit, nëpërmjet veprimit të ligjit apo ndryshe.

1.3 Titujt. Titujt e kësaj Marrëveshjeje nuk kanë rëndësi ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

2. Transferimi i marrëveshjeve ekzistuese

2.1 Njohuri për marrëveshjet ekzistuese. Përfituesi konfirmon që ka dijeni të plotë për marrëveshjet ekzistuese.

2.2 Transferimi. Me efekt nga ngjarja e fillimit, Transferuesi transferon për llogari të Aksionarit të Ardhshëm dhe në përmbushje të detyrimit të Aksionarit të Ardhshëm për t'i dhënë kontribut në natyrë Përfituesit dhe Përfituesi merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Transferuesit sipas ose në lidhje me marrëveshjet ekzistuese, ku

a) secili prej huamarrësve dhe Transferuesi lirohen nga detyrimet e mëtejshme kundrejt njëritjetrit sipas ose në lidhje me marrëveshjet ekzistuese dhe të drejtat e tyre përkatëse ndaj njëritjetrit anulohen (Të drejtat dhe detyrimet e anuluar), dhe

b) secili prej huamarrësve dhe Përfituesi marrin përsipër ndaj njëritjetrit detyrimet dhe/ose përftojnë ndaj njëritjetrit të drejta që ndryshojnë nga të drejtat dhe detyrimet e anuluar në masën që Huamarrësi përkatës dhe Përfituesi kanë marrë përsipër dhe/ose i kanë përftuar ato në vend të atij Huamarrësi dhe Transferuesit.

2.3 Veprim i mëtejshëm. Transferuesi dhe Aksionari i Ardhshëm, përkatësisht edhe Përfituesi, ndërmarrin secili ata hapa dhe përfundojnë ato dokumente të tjera që mund të jenë të nevojshme në mënyrë që Përfituesi të mund të marrë përsipër, në masën më të gjerë të lejuar nga marrëveshja përkatëse ekzistuese dhe në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjeve përkatëse ekzistuese, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Transferuesit në lidhje me secilën prej marrëveshjeve ekzistuese, nga dhe pas ngjarjes së fillimit.

3. Qëllimi i transferimit dhe kontributit

3.1 Marrëveshjet ekzistuese. Transferimi i marrëveshjeve ekzistuese në pajtim me pikën 2.2 të kësaj Marrëveshjeje përmbush detyrimet e Aksionarit të Ardhshëm kundrejt Përfituesit për të dhënë kontribut në natyrë.

3.2 Pagesat me para në dorë. Nëse nuk përcaktohet ndryshe nga Transferuesi, pagesa e çdo shume në para nga Transferuesi për llogari të Aksionarit të Ardhshëm në llogaritë e treguara në seksionin 5 të formularit përkatës të kontributit në ose rreth datës së kësaj Marrëveshjeje përmbush detyrimet e Aksionarit të Ardhshëm kundrejt Përfituesit për të dhënë një kontribut në para.

4. Kufizimi i përgjegjësisë

4.1 Përfundimi i përfaqësimeve dhe garancive. As Transferuesi dhe as Aksionari i Ardhshëm

nuk bën asnjë përfaqësim ose garanci dhe nuk merr përgjegjësi ndaj Përfituesit për:

a) ligjshmërinë, vlefshmërinë, efektivitetin, përshtatshmërinë ose ekzekutueshmërinë e marrëveshjeve ekzistuese ose të çdo dokumenti tjetër;

b) gjendjen financiare të çdo huamarrësi;

c) përmbushjen dhe respektimin nga çdo huamarrës të detyrimeve të tij sipas marrëveshjeve ekzistuese ose të çdo dokumenti tjetër; ose

d) saktësinë e çdo deklarami (me shkrim ose me gojë) të bërë në ose në lidhje me ndonjë marrëveshje ekzistuese ose çdo dokument tjetër,

dhe përjashtohet çdo përfaqësim ose garanci e përfshirë në ligj.

4.2 Rëndimet me barrë. Në pajtim me pikën 4.1, Transferuesi dhe Aksionari i Ardhshëm i garantojnë Përfituesit që deri në ngjarjen e fillimit Transferuesi do të jetë pronari i titullit në çdo marrëveshje ekzistuese, dhe që as Transferuesi dhe as Aksionari i Ardhshëm nuk kanë transferuar, rënduar, lënë peng ose vendosur barrë dhe nuk kanë rënë dakord të transferojnë, rëndojnë, lënë peng ose vendosin barrë mbi një pjesë ose të gjithë të drejtën, titullin ose interesin në çdo marrëveshje ekzistuese ndaj asnjë personi (të ndryshëm nga Përfituesi sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas çdo marrëveshjeje ose dokumenti në lidhje me këtë).

4.3 Vlerësimi i kredisë. Përfituesi i konfirmon Transferuesit dhe Aksionarit të Ardhshëm që ai ka bërë (dhe do të vazhdojë të bëjë) hetimin dhe vlerësimin e tij të pavarur të gjendjes financiare dhe veprimeve të secilit huamarrës dhe subjekteve të tij përkatëse, në lidhje me pjesëmarrjen në këtë Marrëveshje dhe nuk është mbështetur përjashtimisht në asnjë informacion që i është dhënë atij nga Transferuesi ose Aksionari i Ardhshëm, në lidhje me çdo marrëveshje ekzistuese.

5. Zhdëmtimi, detyrimet, kostot dhe shpenzimet

5.1 Zhdëmtimi. Përfituesi zhdëmtton përkatësisht Transferuesin dhe Aksionarin e Ardhshëm, dhe e mban Transferuesin dhe Aksionarin e Ardhshëm të ruajtur nga të gjitha dëmtimet, kostot, shpenzimet, kërkesat dhe dëmtimet e çdo lloji që mund të vuajë ose shkaktojë Transferuesi ose Aksionari i Ardhshëm, në lidhje me një detyrim ose përgjegjësi të Transferuesit ose Aksionarit të Ardhshëm në ose pas ngjarjes së fillimit sipas marrëveshjeve ekzistuese në lidhje me çdo periudhë që fillon në ose pas ngjarjes së fillimit dhe në lidhje me çdo marrëveshje ekzistuese ose një pjesë të saj.

5.2 Detyrimet, kostot, shpenzimet. Taksat, tarifën, detyrimet e tjera publike, kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifën dhe shpenzimet ligjore) të shkaktuara në lidhje me përgatitjen, negocimin, përfundimin, regjistrimin, zbatimin, ndryshimin, ruajtjen ose ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo dokumenti tjetër në lidhje me të, si dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo mbulohen nga Përfituesi.

6. Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet e paqëllimshme

Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose nëse kjo Marrëveshje përmban boshllëqe të paqëllimshme, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë që afrohet sa më shumë të jetë e mundur me qëllimin dhe synimin e dispozitës së pavlefshme. Palët do të mbushin çdo boshllëk të paqëllimshëm me një dispozitë që përputhet më mirë me qëllimin dhe synimin e kësaj Marrëveshjeje.

7. Njoftimet; Ndryshimet

7.1 Me shkrim. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë me shkrim. Të gjitha duhet të jenë të nënshkruara dhe të paraqiten si një dokument origjinal ose me faks.

7.2 Adresat. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohet në adresën e mëposhtme:

Për Transferuesin dhe Aksionarin e
Ardhshëm:

Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", nr. 4
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Faks: +355 251 388

Për Përfituesin:

The European Fund For Southeast Europe
c/o Citibank International plc
(Luxembourg Branch)
Attention : Fund Corporate Services
Atrium Business Park 31
Z.A. Bourmicht
L-8760 Bertrange
Fax: +352 45 14 14 439

7.3 Ndryshimet. Çdo shtesë ose ndryshim në këtë Marrëveshje duhet të jetë me shkrim në pajtim me pikën 7.1. Çdo heqje dorë nga kërkesa e formës shkresore duhet të bëhet me shkrim.

8. Ligji dhe juridiksioni

8.1 Ligji i zbatueshëm. Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji shqiptar.

8.2 Juridiksioni. Gjykata e Tiranës ka juridiksion përjashtues për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë një mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë.

Përfunduar në (tri) kopje, secila prej të cilave është origjinale.

Berlin,
[***]
Fondacioni për Financimin dhe
Zhvillimin e Ndërmarrjeve

Berlin,
[***]
Republika e Shqipërisë
përfaqësuar nga Ministria e
Financave

Berlin,
[***]
Fondi European për
Europës Juglindore SA,
SICAV-SIF

Nga:
.....
Emri: Roland Siller
Titulli: Anëtar bordi

Nga:
.....
Emri: Ridvan Bode
Titulli: Ministër i Financave

Nga
.....
Emri: Dr. Klaus Glaubitt
Titulli: Kryetar bordi

Nga:
.....
Emri: Monika Beck
Titulli: Anëtar Bbrdi

ANEKSI 1 LISTA E MARRËVESHJEVE

- a) Marrëveshja e huasë ndërmjet Fondacionit për Financimin e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimit (FEFAD) dhe Bankës FEFAD sh.a. për 10,000,000.00 DEM të datës 31 mars 1999;
- b) Marrëveshja e huasë ndërmjet Fondacionit për Financimin e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimit (FEFAD) dhe Bankës FEFAD sh.a. për 1,625,000.00 DEM të datës 31 mars 1999;
- c) Marrëveshja e huasë ndërmjet Fondacionit për Financimin e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimit (FEFAD) dhe Bankës FEFAD sh.a. për 1,500,000.00 DEM, të datës 18 korrik 2000;
- d) Marrëveshja e huasë ndërmjet Fondacionit për Financimin e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimit (FEFAD) dhe Bankës FEFAD sh.a. për 447,380.00 euro, të datës 13 shtator 2002;
- e) Marrëveshja e huasë ndërmjet Fondacionit për Financimin e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimit (FEFAD) dhe Partnerit Shqiptar në Mikrokredi sh.a. Tirana për 400,000.00 euro, të datës 13 maj 2004.

ANEKSI 2
PËLQIMI I HUAMARRËSIT
SHIH LETRAT E VEÇANTA

ProCredit Bank Shqipëri, sh.a.
Drejtuar: Borislav Kostadinov
Menaxher i përgjithshëm
Rr: Sami Frashëri
Shqipëri

Ines Ebrecht
Nr ref. Ebr
Tel. +49697431-3968
Fax. +49697431-
e-mail: ines.ebrecht@kfw.de
Datë 09.12.2008

Krijimi i një nënfondi shqiptar brenda Fondit European për Europën Juglindore(EFSE)
Transferimi i marrëveshjeve

I dashur z Kostadinov,

Siç është diskutuar me z Frieder Woehrmann qeveria shqiptare vendosi të kontribuojë sendet pasurore të Fondacionit për Financimin e Ndërmarrjeve dhe Zhvillimin (FEFAD) në Fondin European për Europën Juglindore (EFSE). Kjo do të japë mundësi për krijimin e një nënfondi shqiptar brenda EFSE-së dhe do t'i japë mundësi Republikës së Shqipërisë për të marrë pjesë në produktet dhe instrumentet e ofruara nga EFSE.

Duke iu referuar Marrëveshjes së huasë ndërmjet FEFAD-it dhe Bankës FEFAD sh.a. (siç quhej më parë Banka ProCredit) për 1,625,000.00 DEM, të datës 31 mars 1999, Marrëveshja e huasë ndërmjet FEFAD-it dhe Bankës FEFAD sh.a. për 10,000,000.00 DEM të datës 31 mars 1999, Marrëveshja e huasë ndërmjet FEFAD-it dhe Bankës FEFAD sh.a. për 1,500,000.00 të datës 18 korrik 2000, dhe Marrëveshja e huasë ndërmjet FEFAD-it dhe Bankës FEFAD sh.a. për 447.380.00 euro, të datës 13 shtator, 2002, së bashku me: i) çdo amendim dhe/ose riformulim të përfunduar prej tyre; ii) çdo marrëveshje garancie dhe marrëveshje tjetër të bërë ndërmjet jush dhe KfW-së që u përkasin atyre ("Marrëveshjet"), ne do të donim të kërkonim pëlqimin tuaj për transferimin e atyre marrëveshjeve tek EFSE.

Arritjet e FEFAD-it deri tani dhe nevoja e perceptuar për financim të vazhduar, shtesë të zhvillimit në rajon e kanë çuar qeverinë shqiptare dhe KfW-në të bien dakord për një transferim të sendeve pasurore të FEFAD-it në nënfondin e porsakrijuar shqiptar për të mundësuar misionin fillestar të financimit për zhvillim të FEFAD-it për një afat më të gjatë dhe për të shtuar fondin ekzistues duke tërhequr investitorë të rinj me kushte të favorshme.

Fondet e dhëna Bankës ProCredit sipas marrëveshjeve të përmendura më sipër i jepen EFSE-së si një kontribut në natyrë. Për pasojë, synohet që Marrëveshjet e përcaktuara më sipër t'i transferohen EFSE-së, që do të zëvendësojnë fondet ekzistuese dhe KfW-në si një palë kontraktuese të Marrëveshjet dhe menaxher i fondeve ekzistuese.

Sipas deklarimit të misionit të saj, EFSE do të ruajë mbështetjen e fuqishme për zhvillim të fondeve ekzistuese me synim nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe përparimit në rajonin e Europës Juglindore nëpërmjet sigurimit të qëndrueshëm të financimit shtesë për zhvillimin, nëpërmjet institucioneve të kualifikuara financiare. Në ndjekjen e qëllimit të saj të zhvillimit EFSE do të respektojë parimet e qëndrueshmërisë dhe përveç kësaj, duke kombinuar mandatin publik dhe orientimin e tregut.

Për pasojë, EFSE do të vazhdojë me raportin e biznesit me institucionin tuaj mbi bazën e Marrëveshjeve dhe pritet të jetë një partner kontraktues i qëndrueshëm në të njëjtën mënyrë siç ishte KfW-ja në kapacitetin saj si menaxhere e fondeve ekzistuese për gjatë viteve të fundit.

Në këtë aspekt, jeni të lutur të jepni pëlqimin tuaj për transferimin e çdo dhe të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të KfW-së sipas Marrëveshjeve për EFSE-n me efekt nga themelimi i saj në atë formë dhe mënyrë që mendohet i përshtatshëm nga KfW-ja për të siguruar një zbatim të shpejtë të EFSE-s. KfW-ja ose EFSE do t'ju informojnë për datën në të cilën do të kryhet transferimi i të drejtave dhe detyrimeve të KfW-së tek EFSE dhe llogarinë dhe të dhënat e kontaktit për EFSE-n që do të zbatohet nga ai moment në vend të të dhënave të KfW-së.

Për më tepër, ne u kërkojmë të bini dakord të bashkëpunoni me ne dhe/ose EFSE-në, me qëllim që të përfundohet transferta, veçanërisht për të ekzekutuar të gjitha ato dokumente dhe instrumente, dhe për të ndërmarrë të gjitha ato veprime dhe sende të tjera që KfW-ja ose EFSE mund t'i përcaktojnë të nevojshme për t'i dhënë fuqi transfertës së marrëveshjeve ose për t'u dhënë fuqi dispozitive të marrëveshjeve menjëherë sapo t'i jenë transferuar EFSE-s, duke përmbledhur, pa kufizim, nënshkrimin, vulosjen, përfundimin dhe dhënien e të gjitha dokumenteve, instrumenteve, njoftimeve dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme ose të këshillueshme për qëllimin e mbajtjes, përmirësimit, ruajtjes, sigurimit ose mbrojtjes së një garancie të dhënë në pajtim me marrëveshjet.

Jeni i lutur të tregoni pëlqimin tuaj për sa më sipër duke nënshkruar kopjen e kësaj letre dhe kthyer atë neve në rastin tuaj më të parë, por jo më vonë se 25 shtator 2008.

Sinqerisht i Juaji

KfW

(Beck) (Ebrecht)

Lexuar dhe rënë dakord:

ProCredit Bank Shqipëri sh.a.

CEO

Zëvendëskryetari

Fax-Nr. 00355 4 246 268

Partneri Shqiptar në Mikrokredi sh.a.

Menaxheri i Përgjithshëm

Rr: Gjin Bue Shpata, nr. 7/1

Tirane

Shqipëri

Ines Ebrecht

Ref jonë.: Ebr

phone: +49 69 7431-3968

fax: +49 69 7431-

email: ines.ebrecht@kfw.de

datë: 09-15-2008

Krijimi i një nënfondi brenda Fondit European për Europën Juglindore (EFSE)

Transferimi i marrëveshjeve

Të nderuar zotërinj,

Qeveria shqiptare vendosi të kontribuojë sendet pasurore të fondacionit për financimin e ndërmarrjeve dhe zhvillim (FEFAD) në Fondin European për Europën Juglindore (EFSE). Kjo do të japë mundësi për krijimin e një nënfondi shqiptar brenda EFSE-së dhe do t'i japë mundësi Republikës së Shqipërisë për të marrë pjesë në produktet dhe instrumentet e ofruara nga EFSE.

Duke iu referuar marrëveshjes së huasë ndërmjet FEFAD dhe partnerit shqiptar në mikrokredi sh.a. (PSHM) për 400,000.00 euro të datës 13 maj 2004 së bashku me: i) çdo amendim dhe/ose riformulim të përfunduar prej tyre; ii) çdo marrëveshje garancie dhe ndonjë marrëveshje tjetër të bërë ndërmjet jush dhe KfW-së që u përkasin atyre (marrëveshjet), ne do të donim të kërkonim pëlqimin tuaj për transferimin e kësaj marrëveshje tek EFSE.

Arritjet e FEFAD-it deri tani dhe nevoja e perceptuar për financim të vazhduar, shtesë të zhvillimit në rajon e kanë çuar qeverinë shqiptare dhe KfW-në të bien dakord për një transferim të sendeve pasurore të FEFAD-it në nënfondin e porsakrijuar shqiptar për të mundësuar misionin fillestar të financimit për zhvillim të FEFAD-it për një afat më të gjatë dhe për të shtuar fondin ekzistues duke tërhequr investitorë të rinj me kushte të favorshme.

Fondet e dhëna bankës PSHM sipas marrëveshjeve të përmendura me sipër i jepen EFSE-së

si një kontribut në natyrë. Për pasojë, synohet që marrëveshja e përcaktuar më sipër t'i transferohet EFSE-së, që do të zëvendësojnë fondet ekzistuese dhe KfW-në si një palë kontraktuese të marrëveshja dhe menaxheri i fondeve ekzistuese.

Sipas deklarimit të misionit të saj, EFSE do të ruajë mbështetjen e fuqishme për zhvillim të fondeve ekzistuese me synim nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe përparimit në rajonin e Europës Juglindore nëpërmjet sigurimit të qëndrueshëm të financimit shtesë për zhvillimin, nëpërmjet institucioneve të kualifikuara financiare. Në ndjekjen e qëllimit të saj të zhvillimit EFSE do të respektojë parimet e qëndrueshmërisë dhe përveç kësaj, duke kombinuar mandatin publik dhe orientimin e tregut.

Për pasojë, EFSE do të vazhdojë marrëdhëniet e biznesit me institucionin tuaj mbi bazën e marrëveshjes dhe pritet të jetë një partner kontraktues i qëndrueshëm në të njëjtën mënyrë siç ishte KfW në kapacitetin saj si menaxhere e fondeve ekzistuese për gjatë viteve të fundit.

Në këtë aspekt, jeni të lutur të jepni pëlqimin tuaj për transferimin e çdo dhe të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të KM-së sipas marrëveshjes për EFSE-n me efekt nga themelimi i saj në atë formë dhe mënyrë që mendohet i përshtatshëm nga KfW-ja për të siguruar një zbatim të shpejtë të EFSE-së. KfW-ja ose EFSE do t'ju informojnë për datën në të cilën do të kryhet transferimi i të drejtave dhe detyrimeve të KfW-së tek EFSE dhe llogarinë dhe të dhënat e kontaktit për EFSE-në që do të zbatohet nga ai moment në vend të të dhënave të KfW-së.

Për më tepër, ne u kërkojmë të bini dakord të bashkëpunoni me ne dhe/ose EFSE-n me qëllim që të përfundohet transferta, veçanërisht për të ekzekutuar të gjitha ato dokumente dhe instrumente, dhe për të ndërmarrë të gjitha ato veprime dhe sende të tjera që KfW-ja ose EFSE mund t'i përcaktojnë të nevojshme për t'i dhënë fuqi transfertës së marrëveshjeve ose për t'u dhënë fuqi dispozitive të marrëveshjeve menjëherë sapo t'i jenë transferuar EFSE-së, duke përmblodhur, pa kufizim, nënshkrimin, vulosjen, përfundimin dhe dhënien e të gjitha dokumenteve, instrumenteve, njoftimeve dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme ose të këshillueshme për qëllimin e mbajtjes, përmirësimit, ruajtjes, sigurimit ose mbrojtjes së një garancie të dhënë në pajtim me marrëveshjet.

Jeni i lutur të tregoni pëlqimin tuaj për sa më sipër duke nënshkruar kopjen e kësaj letre dhe kthyer atë neve në rastin tuaj më të parë, por jo më vonë se 25 shtator 2008.

ANEKSI 3 FORMULAR REGJISTRIMI

Fondi European për Europën Juglindore
Atrium Business Park
31, z.a. Bourmicht
L-8070 Bertrange
Grand Duchy of Luxembourg
RCS Luxembourg B 114 452

1. Të dhëna për kërkesin

Emri: Republika e Shqipërisë

Adresa:

Qyteti:

Kodi postar

Vendi: Shqipëri

Personi i kontaktit:

Telefon:

Faks:

E-mail:

2. Zgjedhja e nënfondit

Emrat e nën-Fondit	Klasa e aksioneve	Transhi	Regjistrimi në natyrë		
			Në natyrë (euro)	Në para (Euro)	Totali (Euro)
Fondi European për Europën Juglindore – Shqipëri C Nënfondit	C	1	Shuma treguese e datës xx ¹	Shuma treguese e datës xx ²	Shuma treguese e datës xx ³

3. Karakteristikat e aksioneve

Aksionet për të cilat ne regjistrohemi kanë karakteristikat e përgjithshme të parashikuara në prospektin dhe karakteristikat specifike të mëposhtme:

- Aksionet C – Transhi 1: Të ardhurat e përcaktuara të synuara prej 2.2% në vit
Klasa e shpërndarjes së aksioneve (TBD)

4. Data e regjistrimit

Ne regjistrohemi për aksionet për datën e mëposhtme të regjistrimit.

Ne jemi në dijeni që ne do të marrim numrin e aksioneve të nënfondit të barabartë me shumat përkatëse të regjistrimit të pjesëtuara me çmimin fillestar të ofertës në datën e mësipërme të nënshkrimit.

5. Pagesa për regjistrimet

Regjistrimi në para

Ne do të bëjmë pagesat e regjistrimit nëpërmjet transfertës elektronike sipas detajeve të mëposhtme:

Shuma:

Data e vlefshmërisë:.....

Emri i llogarisë: Citybank International plc (Luxembourg Branch)

Numri i llogarisë: 8543631 tek Citibank London

IBAN: GB46CITI18500808543631

Swift Code: CITIGB2L

Referenca: Regjistrimi për EFSE – Aksionet C Shqipëri

Regjistrimi në natyrë

Dorëzimi i regjistrimit në natyrë duhet të bëhet në datën e mësipërme të regjistrimit në formularin e përshtatshëm për ta bërë këtë dorëzim të efektshëm dhe të ekzekutueshëm ndaj palëve të treta.

6. Identifikimi

Ne bashkëngjisim një listë të nënshkruesve të autorizuar ose prova të autoritetit nënshkrues të personit(ave) që nënshkruajnë këtë formular regjistrimi ose që mund të komunikojnë me shoqërinë me shkrim.

7. Transferimi, cedimet, detyrimet

Asnjë transfertë ose cedim (këtu quhen “transferta”) i ndonjë aksioni nuk është i vlefshëm, përveç kur bëhet në pajtim me termat dhe dispozitat e prospektit dhe të neneve. Çdo përpjekje për një transfertë duke shkelur këtë dispozitë nuk do të njihet. Shoqëria mund të zbatojë dispozitat e këtij paragrafi drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjentëve të saj, duke refuzuar të regjistrojë çdo transfertë të propozuar që nuk është në pajtim me këtë dispozitë.

8. Deklarimet dhe nënshkrimet

a) Në pranojmë që kemi marrë dhe lexuar prospektin aktual (me raportet e bashkëngjitur), kuptojmë dhe pranojmë objektivat, rreziqet dhe prospektet e Fondit European të Europës Juglindore.

b) Ne kemi lexuar dhe jemi të njohur me prospektin dhe veçanërisht “Faktorët e rrezikut” të parashikuar në këtë dokument dhe nenet; ne nuk jemi pajisur dhe nuk mbështetemi në ndonjë informacion tjetër në lidhje me aksionet.

c) Ne jemi në dijeni që aksionet nuk janë dhe nuk do të regjistrohen sipas Aktit SHBA-së për Letrat me Vlerë të vitit 1933 ose ligjeve të një vendi tjetër.

d) Ne nuk po i blejmë aksionet, me qëllim për t'i ofruar ose shitur në një shpërndarje (në kuptimin e Aktit të Letrave me Vlerë) që do të shkelte ligjet e letrave me vlerë të SHBA-së ose një

¹ Vlerësimi përfundimtar 10 ditë nga data e kryerjes së transfertës

² Vlerësimi përfundimtar 10 ditë nga data e kryerjes së transfertës

³ Vlerësimi përfundimtar 10 ditë nga data e kryerjes së transfertës

shteti të saj ose një juridiksion tjetër.

e) Asnjë nga aksionet që ne përftojmë këtu (ose interes i tyre) përftohet ose nuk do të mbahet në çdo kohë, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, për llogari ose përfitim të një personi në SHBA sipas përkufizimit në bazë të Rregullores S të shpallur sipas Aktit të SHBA-ve për Letrat me Vlerë të vitit 1933, dhe asnjë nga këta aksione nuk mund të transferohet te ndonjë person që nuk ka paraqitur një përfaqësim të ngjashëm.

f) Neve na është dhënë mundësia për të marrë informacion në lidhje me biznesin, menaxhimin dhe prospektet e shoqërisë të mjaftueshme për të na dhënë mundësinë për të vlerësuar investimin tonë në aksionet.

g) Neve na është dhënë mundësia (A) të bëjmë ato pyetje që neve na janë dukur të nevojshme dhe të marrim përgjigje nga përfaqësuesit e shoqërisë në lidhje me termat dhe kushtet e ofrimit të aksioneve dhe avantazhet dhe rreziqet e investimit në aksione, dhe (B) për të marrë atë informacion shtesë që shoqëria zotëron dhe mund të përftojë pa përpjekje ose shpenzime të paarsyeshme që janë të nevojshme për të verifikuar saktësinë dhe plotësinë e informacionit që gjendet në prospekt.

9. Zhdëmtimi

Ne konfirmojmë që ne do të ruajmë të padëmtuar dhe zhdëmtojmë shoqërinë dhe/ose Citibank International plc (Luxemburg Branch) (në cilësinë e saj si regjistruar i shoqërisë) në lidhje me çdo humbje që rrjedh prej tyre si rezultat i përfuturit, mbajtjes dhe/ose transferimit të aksioneve prej nesh që nuk do të përputheshin me përfaqësimet dhe garancitë e përmendura më sipër.

Bërë në dy kopje në Luxembourg, më (...)

Emri i të regjistruarit: Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave

Emri dhe nënshkrimi i nënshkruesit të autorizuar: (...) _____

Njohur dhe rënë dakord:

Fondi European për Europën Juglindore

Emri dhe nënshkrimi i nënshkruesit të autorizuar:

Vendi dhe data e nënshkrimit: Luxembourg (...)

Citibank International plc (Luxembourg Branch)

Emri dhe nënshkrimi i nënshkruesit të autorizuar:

Vendi dhe data e nënshkrimit: Luxembourg (...)

LIGJ

Nr.10 046, datë 24.12.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË DHE TË PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS GJERMANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (KfW) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “SISTEMI I KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA, KORÇA IV”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë dhe e projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ndërmarrja e Ujësjetës-Kanalizimeve, Korçë (UKKO) dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) për financimin e projektit “Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza, Korça IV”, me një hua prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë)

eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6003, datë 13.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE PROJEKTI DHE HUAJE

E DATËS 8 TETOR 2008 NDËRMJET BANKËS GJERMANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (KfW), FRANKFURT AM MAIN, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCËVE, TIRANË (“HUAMARRËSI”) DHE NDËRMARRJA UJËSJELLËS- KANALIZIMEVE KORÇË (UKKO), KORÇË (“AGJENCIA PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT”) PËR 15,000,000.00 EURO - HUA

Parathënie

Qeveria Gjermane nëpërmjet KfW mbështet përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ujit të pijshëm në Korçë me financimin e bashkëpunimit financiar që përfshin 19,57 ml. euro të fondit të grantit. Kjo hua dhe marrëveshja e Projektit shërben për të përfunduar këtë mbështetje.

Bazë për këtë marrëveshje është marrëveshja që pritet të përfundojë midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë në lidhje me bashkëpunimin financiar (FC) (“Marrëveshje Qeveritare”).

KfW do të financojë sërish huanë e dhënë në përputhje me kushtet e kësaj kontrate nga fondet e saj, si edhe nga fondet buxhetore me interes të ulët të ofruara nga Republika Federale e Gjermanisë për projektet që përbushin standardet e politikave të zhvillimit për projektet e pranueshme. Termat dhe kushtet e huasë i përbushin kërkesat e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE) për t’u njohur si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja do t’i japë Huamarrësit një hua që nuk e kalon shumën prej 15,000,000.00 euro.

1.2 Qëllimi. Huamarrësi do t’ia kalojë huanë Agjencisë së Zbatimit të Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit duhet ta përdorë huanë vetëm për financimin e përfundimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, zëvendësimin e rrjetit të kanalizimeve dhe ndërtimin e kolektorëve kryesorë dhe e një pike shkarkimi të ujit të shirave në qytetin e Korçës, si dhe për shërbimet përkatëse të konculencës (Projekti). Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e projektit, si edhe mallrat e shërbimet që do të financohen nga huaja nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, për të cilën duhet të bihet dakord me Huamarrësin e përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 Taksat, pagesat publike, detyrimet doganore. Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga Huamarrësi apo Agjencia e Zbatimit të Projektit, si edhe taksat doganore nuk do të financohen nga huaja.

2. Kalimi i Huasë tek Agjencia e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrëveshje e veçantë huaje. Huamarrësi do t’ia kalojë huanë Agjencisë Zbatuese në bazë të një marrëveshjeje të veçantë huaje. Agjencia Zbatuese e Projektit do të shlyejë shumën totale të principalit dhe interesin e paguar KfW-së nga Huamarrësi të shpërndara në mënyrë të barabartë brenda një periudhe prej 30 vjetësh që përfshin një periudhë kohe shtesë shlyerjeje prej 10 vjetësh, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së huasë.

2.2 Përkthim i vërtetuar. Përpara disbursimit të parë nga huaja, Huamarrësi do t’i dërgojë

KfW-së një përkthim të vërtetuar në anglisht të marrëveshjes së veçantë për hua të përcaktuar në nenin 2.1.

2.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk i nënshtrohet asnjë detyrimi. Kalimi i huasë nuk përbën asnjë detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit kundrejt KfW-së në lidhje me detyrime për pagesat që kjo Marrëveshje përcakton.

3. Disbursimi

3.1 Kërkesë për disbursim. Në momentin që të gjitha kushtet para disbursimit në bazë të nenit 3.4 janë plotësuar, KfW-ja do të bëjë disbursimin e huasë në përputhje me ecurinë e projektit dhe sipas kërkesës së Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

3.2 Marrëveshja e veçantë. Nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në mënyrë të veçantë provat që duhet të sigurojë Agjencia e Zbatimit të Projektit, të cilat vërtetojnë se shumat e huasë së kërkuar janë përdorur për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

3.3 Afati i fundit për të kërkuar disbursim. KfW-ja rezervon të drejtën të refuzojë kërkesat për kryerjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2012.

3.4 Kushtet përpara disbursimit. KfW-ja duhet t'i kryejë disbursimet në bazë të kësaj marrëveshjeje vetëm në qoftë se:

a) Huamarrësi ka siguruar prova të kënaqshme për KfW-në, të cilat vërtetojnë se ai i ka përmbushur, sipas ligjeve kushtetuese dhe ligjeve të tjera, të gjitha kërkesat në lidhje me marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve të saj që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë provat sipas nenit 10.4 (Përfshirja nga taksat).

b) Firmat e autorizuara që përmenden në nenin 13.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit dhe i Agjencisë së Zbatimit të Projektit) i janë dërguar KfW-së;

c) Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë që përmendet në nenin 8 është në fuqi dhe vepron pa ndonjë kufizim;

d) Huamarrësi e ka paguar tarifën e menaxhimit të përcaktuar në nenin 4.2;

e) Nuk ka ndodhur asnjë rast mospagimi në kohë.

f) Nuk është krijuar asnjë rrethanë e jashtëzakonshme që të pengojë apo të rrezikojë seriozisht zbatimin, funksionimin apo qëllimin e projektit, ose kryerjen e detyrimeve të pagesës të ndërmarrë nga Huamarrësi në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Përpara disbursimit nga huaja, KfW-ja ka të drejtën t'i kërkojë ato dokumente dhe të dhëna të tjera që ajo i gjykon të nevojshme.

3.5 Heqja dorë nga disbursimi. Duke iu referuar përmbushjes së detyrimeve të tij, në bazë të nenit 11, Huamarrësi mund të refuzojë disbursimin e çdo shume huaje ende të padisbursuar me pëlqimin e KfW-së kundrejt pagesës së një kompensimi në bazë të nenit 3.6.

3.6 Kompensimi. Nëse Huamarrësi e refuzon disbursimin e një shume huaje, ose në qoftë se një shumë huaje nuk është disbursuar aspak ose nuk është disbursuar brenda afatit të përcaktuar në nenin 3.3 për arsye të tjera për të cilat KfW-ja nuk mund të mbajë përgjegjësi, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesën e tij, një shumë të tillë që konsiderohet e nevojshme për të kompensuar KfW-në për humbjet që ka pësuar, shpenzimet apo koston që ka paguar KfW-ja, si rezultat i refuzimit të disbursimit të shumës së huasë në fjalë.

4. Tarifat

4.1 Tarifa e angazhimit. Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme në masën 0.25% në vit për shumat të padisbursuara të huasë. Tarifa e angazhimit do të llogaritet për një periudhë që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që përfundon në datën kur kryhet disbursimi i plotë i huasë. Ajo duhet të paguhet çdo gjatëmuaj dhe për vonesa në kryerjen e pagesave në 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti (secila një "Datë pagese"), por jo më herët se data e pagesës pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe vepron sipas nenit 14.10.

4.2 Tarifa e manaxhimit. Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë manaxhimi të pakthyeshme që paguhet e plotë njëherësh, e barabartë me 0.5% të shumës principale të huasë të përcaktuar në nenin 1.1, me të kaluar një periudhë tremujore pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja, por jo më vonë, ose me të kaluar një periudhë njëmuajore, pasi të hyjë në fuqi kjo Marrëveshje sipas nenit 14.10 (në varësi të datës që është më e vonë) por, sidoqoftë, përpara

disbursimit të parë nga huaja.

5. Interesi

5.1 Interesi (normë fikse interesi e caktuar me angazhimin e huasë.) Huamarrësi do të paguajë interes për huanë në një normë të vendosur nga KfW-ja me të hyrë në fuqi kjo Marrëveshje huaje mbi bazën e kushteve të tregut të kapitaleve që dominojnë në atë kohë në Bashkimin Monetar Europian për huatë afatgjata, duke marrë parasysh koston që duhet të paguajë KfW-ja për fondet rifinancuese siç përmendet në parathënie. Kështu, norma e interesit e përcaktuar nga KfW-ja dhe komunikuar Huamarrësit do të zbatohet deri në fund të afatit të huasë.

5.2 Llogaritja e interesit dhe datat e pagesës së interesit. Interesi mbi një shumë të disbursuar të huasë do të llogaritet duke filluar nga data (duke e përjashtuar) në të cilën është debituar shuma respektive e huasë në llogarinë e huasë që mbahet nga KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë) në të cilën kreditohen shlyerjet respektive në llogarinë bankare të KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3. Interesi do të llogaritet në përputhje me nenin 7.1 (Llogaritja). Interesi do të paguhet me kamatëvonesë në datat e pagesës (siç përcaktohet në nenin 4.1).

6. Shlyerja e Huasë dhe Parapagimi

6.1 Grafiku i shlyerjes. Huamarrësi do ta kthejë huanë si vijon:

Kësti	Data		Shuma	
1	30 qershor	2013	394,000.00	EURO
2	30 dhjetor	2013	394,000.00	URO
3	30 qershor	2014	394,000.00	URO
4	30 dhjetor	2014	394,000.00	EURO
5	30 qershor	2015	394,000.00	EURO
6	30 dhjetor	2015	394,000.00	EURO
7	30 qershor	2016	394,000.00	EURO
8	30 dhjetor	2016	394,000.00	EURO
9	30 qershor	2017	394,000.00	EURO
10	30 dhjetor	2017	394,000.00	EURO
11	30 qershor	2018	395,000.00	EURO
12	30 dhjetor	2018	395,000.00	EURO
13	30 qershor	2019	395,000.00	EURO
14	30 dhjetor	2019	395,000.00	EURO
15	30 qershor	2020	395,000.00	EURO
16	30 dhjetor	2020	395,000.00	EURO
17	30 qershor	2021	395,000.00	EURO
18	30 dhjetor	2021	395,000.00	EURO
19	30 qershor	2022	395,000.00	EURO
20	30 dhjetor	2022	395,000.00	EURO
21	30 qershor	2023	395,000.00	EURO
22	30 dhjetor	2023	395,000.00	EURO
23	30 qershor	2024	395,000.00	EURO
24	30 dhjetor	2024	395,000.00	EURO
25	30 qershor	2025	395,000.00	EURO
26	30 dhjetor	2025	395,000.00	EURO
27	30 qershor	2026	395,000.00	EURO
28	30 dhjetor	2026	395,000.00	EURO
29	30 qershor	2027	395,000.00	EURO
30	30 dhjetor	2027	395,000.00	EURO
31	30 qershor	2028	395,000.00	EURO
32	30 dhjetor	2028	395,000.00	EURO

33	30 qershor	2029	395,000.00	EURO
34	30 dhjetor	2029	395,000.0	EURO
35	30 qershor	2030	395,000.00	EURO
36	30 dhjetor	2030	395,000.00	EURO
37	30 qershor	2031	395,000.00	EURO
38	30 dhjetor	2031	395,000.00	EURO

6.2 Shumat e padisbursuara të huasë. Shumat e huasë të padisbursuara do të balancohen përkundrejt kështit të fundit respektiv të shlyerjes që është për t'u paguar në bazë të grafikut të shlyerjes, përveçse kur KfW-ja, me zgjedhjen e saj, vendos për një mënyrë tjetër balancimi alternativ në raste të veçanta.

6.3 Disbursimet pas fillimit të shlyerjes. Në qoftë se shumat e huasë disbursohen pasi ka filluar shlyerja, grafiku i shlyerjes siç jepet në Nenin 6.1. nuk do të preket, në rast se kështi respektiv për t'u shlyer në bazë të grafikut të shlyerjes është më i vogël se shuma e huasë së papaguar. Nëse kështi për t'u shlyer e tejkalon shumën e huasë së papaguar, KfW-ja do ta zbresë shumën e barabartë me diferencën nga kështi për t'u shlyer, do ta pjesëtojë me kështet e mbetura ende pa paguar dhe do t'ia shtojë këtë shumë çdo kështi të papaguar të shlyerjes. KfW-ja rezervon të drejtën për të shtyrë marrjen në konsideratë të disbursimeve që janë bërë brenda 45 ditëve para datës respektive të agësës për përcaktimin e shumës së huasë së papaguar deri datën e dytë të maturimit pas disbursimit.

6.4 Parapagimi. Për parapagimin aplikohen si më poshtë:

a) E drejta e parapagimit. Në çdo datë pagese, Huamarrësi mund ta shlyejë Huanë plotësisht ose pjesërisht përpara afatit të maturimit, por të paktën në shumën e një kështi të shlyerjes sipas Nenit 6.1. Nëse Huamarrësi e kryen një pagesë të tillë të parakohshme, ai duhet të paguajë një kompensim parapagimi në bazë të nenit 6.4 e).

b) Njoftimi. Pagesa e parakohshme e një shume huaje në bazë të nenit 6.4 a) i nënshtrohet njoftimit për parapagim të KfW-së nga Huamarrësi jo më vonë se data 15, datë pune për bankat, në Frankfurt am Main përpara datës së caktuar për parapagim. Një njoftim i tillë është i pakthyeshëm; ai duhet të specifikojë datën në të cilën do të bëhet parapagimi dhe shumën përkatëse dhe e detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e dhënë në datën e caktuar.

c) Parapagimi i detyrueshëm. Huamarrësi duhet t'i rimbursojë menjëherë KfW-së, me kërkesën e saj, një shumë ose të gjitha shumat e huasë për të cilat Huamarrësi nuk është në gjendje të vërtetojë se janë përdorur për qëllimet për të cilat është rënë dakord.

d) Shumat e huasë për t'u paguar. Huamarrësi do të paguajë gjithashtu shumat e mëposhtme së bashku me parapagimin:

aa) kompensimet për parapagimin në bazë të nenit 6.4 e) që janë për t'u paguar si pasojë e parapagimit; dhe

bb) të gjithë interesin e mbledhur mbi shumën e huasë së papaguar deri datën e parapagimit.

e) Kompensimi për parapagimin. Nëse Huamarrësi e shlyen një shumë huaje përpara afatit të maturimit, Huamarrësi duhet t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesën e këtij të fundit, një shumë në masën që është e nevojshme për të kompensuar ndonjë humbje, shpenzim apo kosto që ka pasur KfW-ja, si pasojë e parapagimit. KfW-ja do të përcaktojë shumën e kompensimit për parapagimin dhe do t'ia komunikojë atë Huamarrësit.

f) Balancimi. Neni 6.2 (Shumat e padisbursuara të huasë) do të aplikojë *mutatis mutandis* për balancimin e pagesave të parakohshme.

6.5 Grafiku i rishikuar për shlyerjen e huasë. Në rast se neni 6.3 (Disbursimet pas fillimit të shlyerjes të huasë) apo neni 6.4 (Parapagimi) gjen zbatim, KfW-ja do t'i dërgojë Huamarrësit një grafik të rishikuar të shlyerjes së huasë, i cili do të bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë grafikët e shlyerjes të vlefshme deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, tarifa e angazhimit, interesi për vonesat në pagesa sipas nenit 7.5, kompensimi i shumës së plotë për shumat që u ka kaluar afati i pagesës sipas nenit 7.6 dhe kompensimi për parapagimin sipas nenit 6.4 e) do të llogariten në bazë të një viti me 360 ditë dhe muaji me 30 ditë.

7.2 Data e caktuar për pagesë. Nëse një pagesë që duhet kryer në lidhje me këtë Marrëveshje

qëllon që duhet të kryhet në një datë që nuk është ditë pune për Bankat, Huamarrësi duhet ta bëjë një pagesë të tillë ditën tjetër të punës. Nëqoftëse dita tjetër e punës qëllon në muajin tjetër kalendarik, kjo pagesë duhet të bëhet në ditën e punës që është para kësaj date.

7.3 Numri i llogarisë bankare, koha e kreditimit. Huamarrësi do të çlirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje, në qoftë se dhe sapo shumat respektive t'i jenë kredituar KfW-së pa zbritje në euro dhe jo më vonë se 10:00 paradite në llogarinë e KfW-së me numër 3100099730, në Frankfurt am Main (bank sort code 500 204 00, BIC KFWIDEFF, me referim shtesë "Ref. YYYYMMDD") ose në një llogari tjetër për të cilën njofton KfW-ja.

7.4 Kundërkërkesat e Huamarrësit. Huamarrësi nuk e ka të drejtën të ushtrojë të drejta të mbajtjes së tatimit në burim apo kundërbalancimit apo të drejta të krahasueshme kundrejt detyrimeve të pagesës në bazë të kësaj Marrëveshjeje, përveç kur të drejta të tilla i njihen nga një vendim deklarativ i gjykatës (rechtskräftig festgestellt) apo kur nuk janë kundërshtuar nga KfW-ja.

7.5 Interesi për vonesa në pagesa. Nëse këstet e shlyerjes apo parapagimet sipas nenit 6.4 (Parapagimi) nuk i paguhen KfW-së në kohë, KfW-ja, pa njoftim paraprak, ka të drejtën të mbajë interes për vonesat në pagesë sipas normës bazë të interesit të bankës duke i shtuar 3% në vit për periudhën që fillon në datën e përcaktuar të pagesës dhe që mbaron në datën kur kjo pagesë derdhet në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3 të kësaj Marrëveshjeje. Kjo normë duhet që të paktën të jetë e barabartë me normën e interesit sipas nenit 5.1 (Interesi). "Norma bazë" është norma e interesit e shpallur si e tillë nga Banka Qendrore Gjermane (Deutsche Bundesbank) që zbatohet në datën përkatëse të caktuar për pagesën. Një interes i tillë i mbajtur për vonesat në pagesë duhet të paguhet menjëherë që me kërkesën e parë të KfW-së.

7.6 Kompensimi i shumës totale. Për shumat që u ka kaluar afati i pagesës (me përjashtim të kësteve të shlyerjes dhe parapagimeve që përmenden në nenin 7.5 [Interesi për vonesat në pagesë] KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë kompensim të shumës totale prej 3% në vit mbi normën bazë që aplikohet në datën respektive të caktuar për pagesën për periudhën që fillon në datën e përcaktuar të pagesës dhe që mbaron në datën kur bëhet pagesa e këtyre shumave që u ka kaluar afati i pagesës. Kompensimi i shumës totale duhet të bëhet me të bërë kërkesën e parë KfW-ja.

7.7 Balancimi. KfW-ja ka të drejtë të balancojë pagesat e marra kundrejt pagesave që janë për t'u kryer sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera huaje të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja do të ketë pretendime për pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje të garantuara nga Republika Federale e Gjermanisë përpara kryerjes së disbursimit të parë.

9. Garancia negative dhe pari passu

9.1 Asetet e projektit. As Huamarrësi e as Agjencia Zbatuese e Projektit nuk mund të lërë peng, hipotekojë, krijojë detyrime të tjera apo të shesë asetet e projektit përpara shlyerjes së plotë të Huasë pa marrë pëlqimin paraprak të KfW-së.

9.2 Pari Passu. Në shkallën që e lejon ligji, Huamarrësi merr përsipër të përmbushë detyrimet e përcaktuara nga kjo Marrëveshjeje pari passu me të gjitha detyrimet e saj ekzistuese apo të ardhshme të pasiguruara dhe jo të varura të pagesës.

10. Kostoja dhe detyrimet publike

10.1 Nuk do të ketë zbritje apo mbajtje tatimi në pagesa. Huamarrësi do t'i kryejë të gjitha pagesat e përcaktuara nga kjo Marrëveshjeje pa zbritur nga këto të fundit taksat, detyrime të tjera publike, apo kosto të tjera. Në rast se Huamarrësi është i detyruar nga ligji apo nga arsye të tjera që t'i bëjë këto zbritje apo mbajtje tatimi në pagesa, pagesat e bëra nga Huamarrësi do të rriten në atë masë që konsiderohet e nevojshme në mënyrë që KfW-ja t'i marrë të plota shumat që janë për t'u paguar sipas kësaj Marrëveshjeje pas zbritjes së taksave dhe detyrimeve publike.

10.2 Kostoja. Huamarrësi do të mbulojë të gjithë koston dhe shpenzimet e bëra në lidhje me disbursimin e Hhasë, në veçanti koston e transferimit dhe dërgesës së parave (përfshirë tarifat e konvertimit), si edhe të gjithë koston dhe shpenzimet e bëra në lidhje me mbështetjen apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

10.3 Taksa dhe detyrime të tjera. Huamarrësi do të mbulojë koston e të gjitha taksave dhe detyrimeve të tjera publike, të bëra jashtë territorit të Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

10.4 Përjashtimi nga taksat. Përpara disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi do të sigurojë

që KfW-ja të përjashtohet nga çdo lloj dhe të gjitha taksat mbi të ardhurat nga interesi, komisionet dhe detyrime të ngjashme në Shqipëri kur të japë huanë.

11. Projekti

11.1 Zbatimi i projektit dhe të dhëna të veçanta. Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) Do të përgatisë, zbatojë, vërë në veprim dhe mbështesë financiarisht projektin duke iu përmbajtur praktikave të shëndosha financiare dhe teknike në lidhje me projektin, si dhe në përputhje në thelb me konceptimin e projektit, për të cilin është rënë dakord ndërmjet Agjencisë Zbatuese dhe KfW-së;

b) Do të zgjedhë konsulentë inxhinierë të pavarur dhe të kualifikuar për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit dhe firma të kualifikuara për zbatimin e projektit;

c) Do të lidhë kontratat për mallrat dhe shërbimet, të cilat do të financohen nga huaja pas kryerjes së procedurave të një tenderi ndërkombëtar;

d) Do të mbajë libër llogarish e procesverbale të cilat tregojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për Projektin dhe që identifikojnë në mënyrë të qartë tipin e mallit dhe të shërbimit të financuar nga kjo hua, ose do të caktojë një palë të tretë ta bëjë këtë;

e) Do të bëjë të mundur që përfaqësues të KfW-së, në çdo kohë, të kenë mundësi t'i kontrollojnë këto të dhëna, si dhe çdo dokument tjetër që ka të bëjë me zbatimin dhe funksionimin e projektit, si dhe të vizitojnë zonën e projektit, si dhe të gjitha ndërtimet përkatëse;

f) Do t'i sigurojnë KfW-së çdo informacion dhe të dhënë mbi projektin dhe mbi ecurinë e tij sipas kërkesës së KfW-së;

g) Me iniciativën e vet dhe pa asnjë vonesë:

aa) Do t'i dërgojë KfW-së pyetjet që i kanë ardhur Huamarrësit nga OECD-ja apo anëtarët e saj në bazë të së ashtuquajturës "Marrëveshje për Transparencë të Kreditimeve të Palidhura të ODA-s" pas lidhjes së kontratave për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja dhe do të koordinojë me KfW-në përgjigjen për pyetje të tilla dhe

bb) Do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që bën të pamundur ose rrezikon në mënyrë serioze zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit.

11.2 Marrëveshja e veçantë. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e nenit 11.1 me anë të një marrëveshjeje të veçantë.

11.3 Sigurimi i financimit të plotë. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit do të sigurojnë financimin e plotë të projektit dhe, nëse i kërkohet, do t'i sigurojë KfW-së prova që vërtetojnë se kostot që nuk mbulohen nga huaja janë paguar.

11.4 Informacioni. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit, me iniciativën e tyre, do të njoftojnë menjëherë KfW-në: i) kur ndodh ose mund të ndodhë një rast i mospagimit në kohë; ii) për çdo rrethanë që bën të pamundur ose rrezikon në mënyrë serioze zbatimin, ose qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

11.5 Asistencë. Huamarrësi dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit do ta ndihmojë Agjencinë Zbatuese në përputhje me praktika të qëndrueshme financiare dhe teknike gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, si dhe në shlyerjen e detyrimeve të Agjencisë Zbatuese që përcaktohen në këtë Marrëveshje dhe, veçanërisht, t'i ofrojë Agjencisë Zbatuese të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

11.6 Pajtueshmëria. Huamarrësi, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Agjencia Zbatuese do të sigurojnë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e projektit, lidhjen e kontratës për mallrat dhe shërbimet që do të financohen, dhe me kërkesën për disbursimin e shumave të huasë, të mos kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin, premtojnë ose marrin premtimin për pagesa të paligjshme apo përfitime të tjera në lidhje me këto detyra.

11.7 Transporti i mallrave. Transporti i mallrave, që do të financohet nga huaja do t'u nënshtrohet dispozitave të përcaktuara në marrëveshjen qeveritare, të cilat njihen nga Huamarrësi dhe Agjencia Zbatuese.

12. Rastet e mospagimit në kohë.

12.1 Rastet e Mospagimit në kohë. KfW-ja mund të anulojë huanë plotësisht ose pjesërisht nëse:

a) Huamarrësi nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij ndaj KfW-së, për kryerjen e pagesave në

kohë;

b) Janë shkelur detyrimet e përcaktuara nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet e veçanta që janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje;

c) Huamarrësi dhe/ose Agjencia Zbatuese nuk është në gjendje të vërtetojë se shumat e huasë janë përdorur për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje, ose

d) Kjo Marrëveshje apo ndonjë pjesë e saj nuk ka më efekt detyrues mbi Huamarrësin ose nuk është më e detyrueshme për t'u zbatuar nga ana e Huamarrësit;

e) Krijohen rrethana të veçanta që bëjnë të pamundur ose rrezikojnë në mënyrë serioze zbatimin, funksionimin ose qëllimin e kësaj huaje, ose kryerjen e pagesës së detyrimeve financiare të marra përsipër nga Huamarrësi e të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

12.2 Pasojat ligjore në rastin e mospagimit në kohë. Nëse rastet e përcaktuara në nenin 13.1 janë krijuar dhe nuk janë zgjidhur brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila duhet të jetë të paktën prej 30 ditësh, KfW mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje ose çdo pjesë të saj me pasojë që

a) Të anulohen detyrimet e saj të përcaktuara në këtë Marrëveshje, dhe që:

b) KfW-ja të mund të kërkojë shlyerjen e plotë apo të pjesshme të shumave të huasë së papaguar, si dhe pagimin e të gjithë interesave të mbledhur, si dhe shuma të tjera që janë për t'u paguar në bazë të kësaj Marrëveshjeje, me nenin 7.5 (Interesi për vonesat në pagesa) dhe 7.6 (Kompensimi i shumës totale) që aplikohet në shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 Kompensimi për dëmet. Në rast se kësaj Marrëveshjeje i jepet fund plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë kompensimin në përputhje me nenin 3.6 dhe/ose kompensimin e parapagimit në përputhje me nenin 6.4 e).

13. Përfaqësia dhe deklaratat

13.1 Përfaqësimi i Huamarrësit dhe i Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Ministri i Financave dhe individë të caktuar nga ai/ajo për ta përfaqësuar te KfW-ja dhe të autorizuar për të nënshkruar me anë të firmave të vërtetuara prej tij/saj do të përfaqësojnë Huamarrësin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Agjencisë Zbatuese dhe individë të tillë të caktuar nga ai/ajo për ta përfaqësuar te KfW-ja dhe të autorizuar për të nënshkruar me anë të firmave të vërtetuara prej tij/saj do të përfaqësojnë Agjencinë Zbatuese gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Prokurat e përfaqësimit do të jenë të vlefshme derisa KfW-ja të marrë njoftimin për anulimin e tyre nga përfaqësuesit e autorizuar të Huamarrësit dhe/ose Agjencisë Zbatuese.

13.2 Adresat. Çdo njoftim apo deklaratë në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të bëhen me shkrim. Ato duhet të dërgohen në origjinal ose – me përjashtim të kërkesave për disbursim – me faks. Çdo njoftim apo deklaratë e bërë në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: Kreditanstalt für Wiederaufbau
Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main
Germany
Fax: +49 69 7431- 2944

Për Huamarrësin: Ministria e Financave
Bul. “Dëshmorët e Kombit,” nr.4
Tirana
Republika e Shqipërisë
Fax: +355- 42-228494

Për Agjencinë Zbatuese: Water Supply and Sewerage Enterprise
Ujësjellës-Kanalizime Korça (UKKO)
Rr. “Unaza e Qytetit” Rajoni nr. 2
Korçë, Albania
Fax: +355-82- 457 59

14. Dispozita të përgjithshme

14.1 Ditë pune. Kur në këtë Marrëveshje përdoret termi “Ditë pune”, ai nënkupton çdo ditë,

me përjashtim të së shtunës dhe të dielës, në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Main janë të hapura për veprime bankare të përgjithshme.

14.2 Vendi i shlyerjes së detyrimeve. Vendi i shlyerjes së të gjitha detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje është Frankfurt am Main.

14.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet. Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, ose në rast se ka ndonjë boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët pjesëmarrëse në këtë Marrëveshje do të bëjnë zëvendësimin e dispozitave të pavlefshme me dispozitat ligjërisht të vlefshme që i përafrohen më shumë frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme dhe do të mbushin boshllëqet e krijuara në dispozita me dispozita ligjërisht të vlefshme në përputhje me frymën dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

14.4 Forma e shkruar. Amendamentet ose shtesat në këtë Marrëveshje duhet të bëhen me shkrim në mënyrë që të jenë të vlefshme. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë për formë të shkruar duhet të njoftohet me shkrim nga palët kontraktuese.

14.5 Transferimi. Huamarrësi nuk mund të caktojë, të transferojë, të lerë peng ose të hipotekojë të drejta nga kjo Marrëveshje.

14.6 Ligji i zbatueshëm. Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga ligjet e shtetit gjerman.

14.7 Periudha e kufizimit. Të gjitha të drejtat që gëzon KfW-ja në bazë të kësaj Marrëveshjeje skadojnë pas pesë vjetësh duke filluar nga fundi i vitit në të cilin ka lindur kjo e drejtë dhe në të cilin KfW-ja është bërë e vetëdijshme për rrethanat që përbëjnë këtë të drejtë ose në të cilin mund të ishte bërë e vetëdijshme në lidhje me to pa neglizhencë të plotë.

14.8 Arbitrazhi. Të gjitha konfliktet që lindin nga kjo Marrëveshje dhe në lidhje me të do të zgjidhen përfundimisht dhe vetëm nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë, do të zbatohen si më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre gjyqtarë të cilët do të emërohen dhe do të veprojnë në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) që gjejnë zbatim herë pas here.

b) Seancat e arbitrazhit do të zhvillohen në Frankfurt am Main. Seancat do të zhvillohen në gjuhën angleze.

14.9 Transmetimi i informacionit. KfW-ja rezervon të drejtën t'i japë Republikës Federale Gjermane informacion lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. KfW-ja dhe Republika Federale e Gjermanisë kanë të drejtën t'u japin informacione në lidhje me huanë dhe projektin, duke përfshirë lidhjen e kontratave për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja, organizatave ndërkombëtare të angazhuara për mbledhjen e të dhënave statistikore sidomos në lidhje me aspekte të shlyerjes së interesit dhe principalit, dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave për lidhjen e kontratave për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja. E drejta e lartpërmendur për t'u dhënë informacion organizatave ndërkombëtare përfshin gjithashtu edhe të drejtën për t'u dhënë drejtpërsëdrejti një informacion të tillë anëtarëve të këtyre organizatave.

14.10 Hyrja në fuqi. Kjo Marrëveshje do të hyjë fuqi pasi të ketë hyrë në fuqi dhe të veprojë Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën ajo bazohet.

Kjo Marrëveshje realizohet në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze____, këtë ditë të, _____2008,

KfW-ja

Ministria e Financës

UKKO

LIGJ
Nr.10 051, datë 29.12.2008

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8737, DATË 12.2.2001 “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2, 83 pika 1, 148 e 149 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas nenit 3 shtohen nenet 3/a, 3/b, 3/c, 3/ç e 3/d me këtë përmbajtje:

“Neni 3/a

Organet e prokurorisë dhe përfaqësimi i saj

1. Organet e prokurorisë janë:

- a) Prokuroria e Përgjithshme e Republikës;
- b) prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;
- c) prokuroritë pranë gjykatave të apelit;
- ç) prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda;
- d) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.

2. Përfaqësimi i prokurorisë bëhet nga:

- a) Prokurori i Përgjithshëm;
- b) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit;
- c) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.

Neni 3/b

Shkalla e hierarkisë në prokurori

1. Shkalla e hierarkisë në prokurori, sipas niveleve të organizimit dhe të funksionimit në drejtimin e centralizuar, nga prokurori më i lartë te prokurori më i ulët, është si më poshtë:

- a) prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme janë prokurorë më të lartë se prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë;
- b) prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit, në gjykimet e çështjeve të apeluara që kanë në juridiksion, janë prokurorë më të lartë se prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, të cilët i përkasin atij juridiksioni;
- c) prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë, sipas kompetencës, lëndore dhe tokësore, janë prokurorë të nivelit të parë në prokurori.

2. Prokurorët, drejtues të drejtorive në Prokurorinë e Përgjithshme, drejtues të prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe drejtues të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, janë prokurorë më të lartë se prokurorët në strukturat përkatëse, ku ata ushtrojnë funksionet.

Neni 3/c

Kufizimet e pushtetit të prokurorit më të lartë

1. Prokurori, në çdo rast të mbështetur në ligj dhe në prova, refuzon përmbushjen e urdhrit ose të udhëzimit, që është haptazi në kundërshtim me ligjin.
2. Refuzimi bëhet me akt të shkruar, në të cilin prokurori arsyeton shkaqet e refuzimit.
3. Në rast refuzimi, drejtuesi i prokurorisë ose prokurori më i lartë, që ka dhënë urdhrin ose udhëzimin, ka të drejtë të zëvendësojë prokurorin, që refuzon, duke proceduar personalisht ose duke ia ngarkuar ushtrimin e ndjekjes penale një prokurori tjetër.
4. Me përjashtim të rasteve haptazi në kundërshtim me ligjin, nuk përbëjnë objekt refuzimi:
 - a) vendimet e marra në rrugë hierarkike, në zbatim të ligjit procedural penal;
 - b) urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni 3/ç

Shmangia e konfliktit të interesit

1. Drejtuesit të prokurorisë së rrethit gjyqësor, drejtuesit të prokurorisë pranë gjykatës së apelit, prokurorit të apelit, prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme apo Prokurorit të Përgjithshëm, kur gjendet në një çështje penale në rastet e parashikuara në nenet 16 e 17 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, i ndalohej t'i japë urdhra dhe udhëzime, me shkrim, prokurorit të çështjes apo të ndikojë në çdo mënyrë tjetër.
2. Në këtë rast drejtuesi në konflikt interesi njofton, me shkrim, Prokurorin e Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm, kryesisht ose me kërkesë, vendos me shkrim për përjashtimin e drejtuesit në konflikt interesi nga procedura e dhënies së urdhrave dhe udhëzimeve. Në këtë vendim, Prokurori i Përgjithshëm cakton nëse dhe në ç'pjesë kanë vlerë veprimet e kryera në bazë të urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna më parë nga drejtuesi në konflikt interesi.
3. Në rastin kur Prokurorit të Përgjithshëm i kërkohet nxjerrja e një urdhri apo dhënia e një udhëzimi në një procedim, në të cilin ai është në konflikt interesi, atëherë ai deklaron, me shkrim, gjendjen e konfliktit të interesit dhe njofton prokurorin, që i ka kërkuar nxjerrjen e urdhrit apo dhënien e udhëzimit. Në këtë rast, urdhri apo udhëzimi nxirret nga prokurori më i vjetër në detyrë, drejtor në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 3/d

Drejtimi në prokurori

1. Prokurori i Përgjithshëm drejton organin e prokurorisë dhe ndihmohet nga drejtuesit e strukturave në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Prokuroritë pranë gjykatave të apeleve drejtohen nga drejtuesi i prokurorisë së apelit, i ndihmuar nga zëvendësi i tij.
3. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë drejtohen nga drejtuesi i prokurorisë, i ndihmuar nga zëvendësit dhe përgjegjësit e sektorëve, aty ku ka të tillë.”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

- a) Në pikën 3, pas fjalës “me shkrim” shtohet fjala “të arsyetuara”.
- b) Paragrafi i dytë i pikës 3 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 7, pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2 e 1/3 me këtë përmbajtje:

- “1/1. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e juristëve me përvojë pune jo më pak se 10 vjet në sistemin e drejtësisë dhe shquhet për aftësi profesionale dhe figurë të pastër etiko-morale.
- 1/2. Prokurori i Përgjithshëm qëndron në detyrë për 5 vjet, me të drejtë riemërimi.

1/3. Pas përfundimit të mandatit, me pëlqimin e tij, ai ka të drejtë të emërohet në funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme ose në vendin e mëparshëm apo në një vend të barasvlefshëm me vendin e mëparshëm. Ai nuk përfiton nga kjo e drejtë, në rastet kur shkarkohet për shkelje të Kushtetutës, për shkelje të rëndë të ligjit ose për akte dhe sjellje, që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit të Përgjithshëm.”.

Neni 4

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Prokurori i Përgjithshëm ka këto detyra kryesore:

a) përfaqëson prokurorinë në kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese;

b) i propozon Presidentit të Republikës numrin e përgjithshëm të prokurorëve, pasi të ketë marrë mendimin e Ministrit të Drejtësisë, si dhe përcakton numrin e prokurorëve, për çdo prokurori, përfshirë edhe Prokurorinë e Përgjithshme;

c) i propozon Presidentit të Republikës emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, largimin nga detyra dhe shkarkimin e prokurorëve;

ç) cakton drejtuesit e prokurorive dhe zëvendësit e tyre në prokuroritë pranë gjykatave, sipas kriterëve dhe procedurave, të përcaktuara në këtë ligj;

d) miraton strukturën, organikën dhe rregulloret e funksionimit të prokurorive pranë gjykatave dhe të Prokurorisë së Përgjithshme;

dh) urdhëron komandimin e prokurorëve, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj;

e) emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm në Prokurorinë e Përgjithshme dhe kancelarët e prokurorive;

ë) përfaqëson prokurorinë në marrëdhëniet me të tretët, në nivel qendror;

f) kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë;

g) drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e prokurorisë dhe të policisë gjyqësore;

gj) nxjerr akte normative (rregullore, urdhra dhe udhëzime), për ushtrimin e detyrave të përcaktuara nga ky ligj ose nga ligje të veçanta, të cilat janë të detyrueshme për prokurorët dhe policinë gjyqësore;

h) urdhëron kryerjen e inspektimeve, fillon procedimin disiplinor dhe vendos për marrjen e masave disiplinore, si dhe urdhëron fillimin e procedimit penal kundër prokurorëve;

i) fillon procedimin disiplinor dhe urdhëron procedimin penal të policisë gjyqësore, në përputhje me ligjin e veçantë;

j) mbikëqyr drejtpërdrejt shërbimin e inspektimit të prokurorisë dhe miraton planin vjetor të inspektimeve të përgjithshme në prokurori;

k) thërret mbledhjen e këshillit të prokurorisë dhe mund të drejtojë mbledhjet e tij;

l) i delegon me shkrim kompetenca drejtorëve, përgjegjësve të sektorëve ose prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas parashikimeve në këtë ligj ose në ligje të veçanta, me përjashtim të atyre që parashikojnë shkronjat “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “gj”, “h” dhe “i” të kësaj pike;

ll) i dërgon Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të ndjekjes penale, për hartimin e statistikës së njësuar në fushën e drejtësisë;

m) kryen detyra të tjera, të parashikuara në ligj.”.

b) Pikat 3 e 4 shfuqizohen.

Neni 5

Në nenin 9 pika 1, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) zyra e ndihmësve ligjorë.”.

Neni 6

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10
Kompetencat

1. Këshilli i prokurorisë kryen funksione këshillimore, në ndihmë të Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Mendimet e këshillit të prokurorisë paraqiten në formë të shkruar, të arsyetuara dhe nënshkruhen nga kryetari. Aktit i bashkëlidhet, detyrimisht, edhe mendimi i anëtarëve në pakicë.
3. Këshilli i prokurorisë ushtron këto kompetenca:
 - a) organizon konkursin për emërimin e kandidatëve për prokuror dhe i jep mendim Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin e prokurorëve në detyrë, shkarkimin e tyre, si dhe çdo nismë tjetër me natyrë disiplinore;
 - b) shqyrton vlerësimin e punës së prokurorëve dhe i paraqet, për miratim, Prokurorit të Përgjithshëm raportin e vlerësimit përfundimtar të aftësive profesionale të prokurorëve;
 - c) i jep mendim Prokurorit të Përgjithshëm për ngritjen në detyrë të prokurorëve, transferimin (lëvizje paralele ose ndryshime të ngjashme), si dhe kandidaturat e drejtuesve të prokurorisë dhe zëvendësit e tyre, duke paraqitur mendimin e tij për kandidatët pas procedurës së konkurrimit të tyre;
 - ç) jep mendim për miratimin, nga Prokurori i Përgjithshëm, të rregullores së këshillit të prokurorisë;
 - d) jep mendim për planin vjetor të inspektimeve dhe tematikën e tyre;
 - dh) merr në shqyrtim dhe jep mendim për vlerësimet e Ministrit të Drejtësisë lidhur me inspektimet e kryera në organe të prokurorisë;
 - e) jep mendim për projekt-aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm, për unifikimin e politikës së ndjekjes penale, në hetim dhe në gjykim, si dhe propozon masa për organizimin e brendshëm dhe miradministrimin e prokurorisë apo përmirësimin e legjislacionit në fushën penale;
 - ë) kryen çdo detyrë tjetër, të caktuar me ligj.
4. Këshilli i prokurorisë shqyrton ankesat për vlerësimin e prokurorëve dhe mund të refuzojë ose ka të drejtë të fillojë rishikimin e vlerësimit, që nuk është pranuar nga prokurori përkatës, sipas rregullave të përcaktuara nga Prokurori i Përgjithshëm.
5. Në rastet kur Prokurori i Përgjithshëm nuk është dakord me mendimet e sugjeruara nga këshilli, vendimmarrjen e tij ndryshe e paraqet në arsyetuar.”.

Neni 7

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Këshilli i prokurorisë përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët gjashtë prokurorë dhe një përfaqësues i Ministrit të Drejtësisë. Në mbledhjen e këshillit mund të marrë pjesë edhe një përfaqësues i Presidentit të Republikës.”.

b) Në fund të pikës 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përbërja e këshillit duhet të jetë si më poshtë:

- a) tre prokurorë, që ushtrojnë funksionet në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë;
- b) dy prokurorë, që ushtrojnë funksionet në prokuroritë pranë gjykatave të apeleve;
- c) një prokuror, që ushtron funksionet në Prokurorinë e Përgjithshme.”.

Neni 8

Në nenin 17, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) ka cilësi të larta morale dhe profesionale.”.

Neni 9

Në nenin 18 bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

a) Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) ka punuar jo më pak se 5 vjet oficer i policisë gjyqësore.”.

b) Në fund të shkronjës “b” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës mund të emërojë në prokuroritë e shkallës së parë, deri në 10 për qind të numrit të përgjithshëm të prokurorëve, shtetas, të cilët kanë punuar më parë prokurorë, gjyqtarë apo oficerë të policisë gjyqësore, që përmbushin kriteret e shkronjave “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë” të nenit 17 dhe të shkronjës “b” të këtij neni.”.

Neni 10

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21 Emërimi

1. Prokurori në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi ky i fundit të ketë marrë mendimin e këshillit të prokurorisë.

2. Prokurori në prokurorinë pranë gjykatës për krime të rënda emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të konkurrimit me jetëshkrime, pasi:

- a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë;
- b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;
- c) të jetë vlerësuar “Shumë mirë”, për aftësi profesionale, dy herët e fundit;
- ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Ndërmjet prokurorëve, që kandidojnë për në prokurorinë pranë gjykatës për krime të rënda dhe që plotësojnë kushtet e pikës 1 të këtij neni, këshilli i prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm përzgjedhin, sipas pikëve, kandidatin, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 3 të nenit 43 të këtij ligji.

4. Presidenti, brenda 30 ditëve, dekreton emërimin në detyrën e prokurorit të kandidatit të propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Pas këtij afati, propozimi vlerësohet i rrëzuar.”.

Neni 11

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24 Transferimi dhe ngritja në detyrë

1. Transferimi i prokurorit nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tij, përveç kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të prokurorisë. Transferimi i prokurorit mund të bëhet vetëm në të njëjtin nivel prokurorie. Kur, për nevoja të riorganizimit të prokurorisë, transferimi i prokurorit shoqërohet me ulje në nivel prokurorie, ai trajtohet me pagën që kishte.

2. Përjashtim nga pika 1 e këtij neni përbën rasti kur jepet masë disiplinore “kalim në një detyrë tjetër më të ulët brenda sistemit të prokurorisë”, parashikuar në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 33 të këtij ligji.

3. Ngritja në detyrë e prokurorit bëhet në bazë të kriterëve të njohura dhe objektive, si meritat dhe përvoja, të parashikuara në nenet 21 pikat 2 e 3 dhe 43 të këtij ligji.”.

Neni 12

Në nenin 25, në fund të shkronjës “a” shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Ky afat mund të zgjatet deri në tetë muaj, nëse prokurori i komanduar jep pëlqimin.”.

Neni 13

Në nenin 26, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Prokurori pezullohet nga ushtrimi i detyrës, kur ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet.”.

Neni 14

Në nenin 27 pika 3, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:
“b) kur merret masë disiplinore sipas shkronjave “c”, “d” dhe “dh” të nenit 32 të këtij ligji.”.

Neni 15

Pas nenit 27 shtohen nenet 27/a, 27/b, 27/c e 27/ç me këtë përmbajtje:

“Neni 27/a

Kushtet dhe emërimi i drejtuesit

1. Drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së apelit dhe drejtuesi i hallkave të strukturës në Prokurorinë e Përgjithshme emërohen nga Prokurori i Përgjithshëm, në bazë të konkurrimit me dokumente.

2. Kandidatët për drejtues, sipas niveleve të prokurorisë, duhet të plotësojnë këto kritere:

- a) të kenë punuar, si rregull, jo më pak se pesë vjet si prokurorë në prokurori të të njëjtit nivel ose të niveleve më të larta;
- b) të jenë vlerësuar “Shumë mirë” dy herët e fundit;
- c) të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- ç) të kenë aftësi organizuese dhe administruese.

Neni 27/b

Largimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtuesit

1. Drejtuesit, sipas niveleve të prokurorisë, shkarkohen nga detyra e drejtuesit:

- a) kur nuk përmbushin detyrat e parashikuara në nenin 27/c të këtij ligji;
- b) në raste të shkarkimit të prokurorit, të parashikuara në nenin 27 të këtij ligji.

2. Drejtuesi, sipas niveleve të prokurorisë, largohet nga detyra e drejtuesit kur:

- a) jep dorëheqjen nga kjo detyrë;
- b) janë raste të largimit të prokurorit, të parashikuara në nenin 27 të këtij ligji;
- c) është në pamundësi fizike të ushtrimit të detyrës, për më shumë se 3 muaj.

3. Largimi apo shkarkimi i drejtuesit nga detyra, sipas niveleve të prokurorisë, bëhet me urdhër të arsyetuar të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 27/c

Kompetencat e drejtuesit

1. Drejtuesit, sipas niveleve të prokurorisë, përveç ushtrimit të funksioneve si prokuror më i lartë, kryejnë edhe këto detyra:

a) përfaqësojnë prokurorinë në marrëdhëniet me të tretët në njësinë administrative, ku ushtron funksionet prokuroria;

b) bëjnë organizimin e punës në prokurori dhe ndarjen e prokurorëve, sipas njësive administrative ose drejtimeve, me grup veprash penale;

c) në fillim të çdo muaji, caktojnë listën e shërbimit të radhës në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, si dhe planifikojnë shpërndarjen e kallëzimeve/referimeve të ardhura në prokurori, sipas kritereve të përcaktuara me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të parimeve të specializimit të prokurorëve dhe të ndarjes së barabartë të punës;

ç) organizojnë diskutime për çështje të natyrës juridike, në bazë të përgjithësimit të përvojës së ushtrimit të ndjekjes penale dhe të praktikës gjyqësore, të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, të vendimeve të Gjykatës Kushtetues dhe vendimeve të tjera gjyqësore në fushën penale, urdhrave, udhëzimeve dhe qarkoreve/porosive të Prokurorit të Përgjithshëm, akteve të kontrollit dhe inspektimeve të ushtruara nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë;

d) mbikëqyrin respektimin e etikës së prokurorit dhe planifikimin e punës së tyre, si dhe

përbushin angazhimet ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore;

dh) marrin kontakt me ekipet e inspektimit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë, njihen me qëllimin dhe objektin e inspektimit dhe u krijojnë atyre mundësi në ushtrimin e detyrës;

e) mbikëqyrin disiplinën në punë të prokurorëve;

ë) bashkërendojnë punën me drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe me Shkollën e Magjistraturës, për çështje të ngritjes profesionale të prokurorëve dhe të policisë gjyqësore;

f) kujdesen për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori;

g) kryejnë detyra të tjera, në funksion të drejtimit administrativ të prokurorisë, të parashikuara në aktet ligjore ose nënligjore në fuqi.

2. Kur drejtuesi mungon, detyrat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kryhen nga zëvendësdrejtuesi i autorizuar prej tij.

Neni 27/ç

Regjistri i prokurorëve

Në Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme krijohet regjistri i prokurorëve të prokurorive pranë gjykatës së shkallës së parë, të prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, i cili përmban të paktën:

a) gjenealogjetet e çdo prokurori;

b) të dhënat e edukimit të tij akademik;

c) datën e emërimit;

ç) pjesëmarrjen në kualifikime dhe trajnime;

d) masat disiplinore, nëse ka;

dh) vlerësimin e tij si prokuror;

e) të dhëna për karrierën;

ë) të dhëna në fushën e publikimeve.”.

Neni 16

Në nenin 30 pika 1, pas fjalëve “duke u paraqitur vetë” shtohen fjalët “dhe/ose mbrojtësi i zgjedhur prej tij”.

Neni 17

Në nenin 34, paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kundër masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, prokurori mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit, Tiranë, ndërsa prokurori pranë kësaj gjykate në gjykatën e apelit më të afërt. Kur gjykata çmon se shkarkimi nga detyra është i pabazuar në ligj, ajo vendos kthimin e tij në detyrë në prokurorinë pranë gjykatës ku ka qenë në momentin e fillimit të procedimit disiplinor dhe t’i japë prokurorit, nëse është e nevojshme, një shpërblim të drejtë.”.

Neni 18

Neni 36 shfuqizohet.

Neni 19

Në nenin 39 pika 2, pas fjalës “mësimdhënies” shtohen fjalët “e cila rregullohet me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm”.

Neni 20

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42

Vlerësimi i punës

1. Vlerësimi i punës së prokurorit bëhet për aftësitë profesionale dhe personale, aftësitë dhe qëndrimin shoqëror, aftësitë administruese, si dhe për respektimin e disiplinës në punë dhe masat disiplinore.

2. Vlerësimi paraprak i punës së prokurorit bëhet nga drejtuesi i prokurorisë. Ky vlerësim shërben si propozim për vlerësimin final të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, që mund të zëvendësojë vlerësimin paraprak, për shkak të një krahasimi të drejtë, në shkallë vendi, të vlerësimeve.

3. Për vlerësimin e punës të prokurorit, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore kryen inspektimin e planifikuar, jo më pak se një herë në tre vjet.

4. Këshilli i prokurorisë shqyrton vlerësimin paraprak të punës dhe ia paraqet mendimin e vet Prokurorit të Përgjithshëm, i cili duhet të shprehet brenda 15 ditëve.

5. Në rastet kur një prokuror bën kërkesë për ngritje në detyrë, transferim ose në një pozicion tjetër, duhet të bëhet një vlerësim i ri, përveç kur vlerësimi i fundit është bërë brenda gjashtë muajve të fundit. Prokurori duhet të njihet me vlerësimin që i është bërë.

6. Vlerësimi i punës së prokurorit është:

- a) “Shumë mirë”;
- b) “Mirë”;
- c) “Mjaftueshëm”;
- ç) “I paaftë”.

7. Vlerësimi “I paaftë” përbën shkak për fillimin e procedurës, për shkarkimin nga detyra të prokurorit.

8. Në rastet kur prokurori është vlerësuar “Mjaftueshëm”, brenda një viti, bëhet rivlerësimi i tij.

9. Për efekt të karrierës profesionale, Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme mban një listë të përhershme të renditjes së prokurorëve për rezultatet e punës, e cila përditësohet në vijimësi.

10. Rregullat për vlerësimin e punës së prokurorit dhe për kriteret e renditjes së prokurorëve në listën e përhershme përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm, pasi të ketë marrë mendimin e këshillit të prokurorisë.”.

Neni 21

Neni 43 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 43

Ngritja në detyrë

1. Prokurori i prokurorisë pranë gjykatës së apelit emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të konkurrimit me dokumente, pasi:

- a) të ketë punuar jo më pak se 7 vjet në prokurorinë pranë gjykatave të shkallës së parë;
- b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;
- c) të jetë vlerësuar “Shumë mirë”, për vlerësimin e punës, dy herët e fundit;
- ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

2. Prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në bazë të konkurrimit me dokumente, pasi:

- a) të ketë punuar jo më pak se 5 vjet në prokurorinë pranë gjykatave të apelit ose 12 vjet në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë;
- b) të jetë dalluar për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;
- c) të jetë vlerësuar “Shumë mirë”, për vlerësimin e punës, dy herët e fundit;

ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

3. Kur konkurrojnë dy ose më shumë kandidatë për në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në Prokurorinë e Përgjithshme, që plotësojnë kushtet e pikave 1 e 2 të këtij neni, këshilli i prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm për zgjedhin, sipas pikëve, kandidatin me më tepër përvojë/vjetërsi në profesion, me më tepër merita/rezultate në punë në vijimësi, si dhe me më tepër veprimtari shkencore/akademike. Rregulla më të hollësishme për pikëzimin përcaktohen me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

4. Presidenti, brenda 30 ditëve, dekreton emërimin në detyrën e prokurorit të kandidatit të propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Me kalimin e këtij afati, propozimi vlerësohet i rrëzuar.”.

Neni 22

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 44

Ruajtja e statusit të prokurorit

1. Prokurorët, me kërkesën e institucioneve dhe me pëlqimin e tyre, mund të shërbejnë për një afat deri në katër vjet në strukturat juridiko-profesionale të Prokurorisë së Përgjithshme, të Ministrisë së Drejtësisë, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në mbarim të këtij afati, me kërkesën e tyre, ata rrimërohen prokurorë, pa konkurs, në vendin që kanë pasur.

2. Trajtimi financiar i prokurorit bëhet nga institucionet përkatëse, duke i dhënë pagën më të lartë ndërmjet dy pagave.

3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si prokuror, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale.”.

Neni 23

Në nenin 50 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Prokurori gëzon të drejtën e një lejeje vjetore të pagueshme prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore, si rregull, bëhet në muajin gusht.”.

b) Në pikën 2 fjalët “në periudhën korrik-” zëvendësohen me fjalën “muajin”.

Neni 24

Në nenin 51, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Për nevoja të kualifikimeve dhe të specializimeve profesionale prokurori ka të drejtë të kërkojë leje të papagueshme dhe ruajtjen e vendit të punës deri në një vit.”.

Neni 25

Neni 52 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 52

Paga, shpërblimet dhe trajtimet

1. Paga e Prokurorit të Përgjithshëm është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

2. Paga e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme është e barabartë me pagën e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Paga e drejtuesve të hallkave, që janë prokurorë në strukturën e Prokurorisë së Përgjithshme, është 5 për qind me e lartë se paga e prokurorëve të kësaj prokurorie.

3. Paga bazë e prokurorit ose drejtuesit të prokurorisë së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe shtesa për vjetërsi apo vështirësi në shërbim e tyre, është e barabartë me pagën dhe shtesën e vjetërsisë dhe të vështirësisë së gjyqtarit e të kryetarit të gjykatës, pranë së cilës funksionon prokuroria, ku ai

është emëruar.

4. Në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, prokurori i gatshëm ose prokurori, që kryen detyra të ngutshme përfiton shtesë page, në masën 50 për qind të pagës së tij ditore.

5. Prokurori mund të përfitojë shpërblime, për merita profesionale, në masën e caktuar, me propozimin e drejtuesit dhe me miratimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

6. Prokurori, me propozimin e eprorit dhe me miratimin e prokurorit të Përgjithshëm, mund të përfitojë deri në 20 për qind shtesë page për vështirësi pune.

7. Prokurorët dhe drejtuesit e tyre kanë të njëjtat trajtime dhe status protokollar si gjyqtarët dhe drejtuesit e gjykatave, pranë të cilave ushtrojnë funksionet prokuroria, përveçse kur ligji parashikon ndryshe.”.

Neni 26

Në nenin 53 pika 1, fjalët “informon Kuvendin” zëvendësohen me fjalët “raporton në Kuvend” dhe fjala “Njoftimi” zëvendësohet me fjalën “Raportimi”.

Neni 27

Në nenin 55, në fund të pikës 1 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Prokurori i Përgjithshëm shqyrton rekomandimin dhe vendos në lidhje me të.”.

Neni 28

Në nenin 56 bëhen këto shtesa:

a) Në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ministri i Drejtësisë paraqet në Kuvend, të paktën një herë në vit, raport me shkrim për inspektimet e kryera nga Ministria e Drejtësisë, duke vënë në dijeni edhe Prokurorin e Përgjithshëm. Raporti përmban të dhëna të përgjithshme për çështjet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të paraqesë në Kuvend mendimin e tij për raportin e dërguar nga Ministri i Drejtësisë, sipas kësaj pike.”.

b) Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Në bazë të rezultateve të kontrollit, Ministri i Drejtësisë, kur është rasti, paraqet rekomandim, për nisjen e procedimit disiplinor, Prokurorit të Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm shqyrton rekomandimin dhe vendos në lidhje me të. Rekomandimi për nisjen e procedimit disiplinor dhe përgjigjja e Prokurorit të Përgjithshëm i njoftohen Presidentit të Republikës.”.

Neni 29

Pas nenit 56 shtohet neni 56/a me këtë përmbajtje:

“Neni 56/a

Marrëdhëniet me policinë gjyqësore

1. Prokurorët drejtojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë hetimore të policisë gjyqësore, duke garantuar respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut.

2. Prokurori ka të drejtë:

a) t’i japë urdhra dhe udhëzimet e duhura policisë gjyqësore për:

i) zbatimin efikas të përparësive të politikës penale;

ii) përcaktimin e kategorive të çështjeve që kanë përparësi dhe mjeteve të përdorura për kërkimin e provës;

iii) kohëzgjatjen e hetimeve, si dhe për t’u informuar në vazhdimësi për ecurinë e hetimeve;

b) t’i caktojë çështje të veçanta strukturave të policisë gjyqësore, sipas juridiksionit dhe llojit të çështjes, si dhe mundësive që ata kanë në kryerjen e hetimeve;

c) të bëjë vlerësime dhe kontrole, për aq kohë sa është e nevojshme, për të mbikëqyrur

zbatimin e ligjit dhe të urdhrave e udhëzimeve të tij;

ç) të kërkojë fillimin e procedimit disiplinor dhe marrjen e masave disiplinore për shkelje të ligjit nga policia gjyqësore.”.

Neni 30

Në nenin 57 pika 2, fjalët “Pranë prokurorive të shkallës së parë” hiqen.

Neni 31

Neni 58 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 58 **Nëpunësit**

1. Sekretari i përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Shërbimet e tjera tekniko-administrative në Prokurorinë e Përgjithshme dhe shërbimet ndihmëse në prokuroritë e niveleve të tjera, pranë sistemit gjyqësor, kryhen nga nëpunës dhe punonjës të tjerë.
3. Sekretari i përgjithshëm drejton veprimtarinë administrative të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive të niveleve të tjera, nën autoritetin e Prokurorit të Përgjithshëm.
4. Punonjësit e administratës së Prokurorisë së Përgjithshme u nënshtrohen rregullave të shërbimit civil. Marrëdhëniet e punës të personelit administrativo-teknik rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.
5. Trajtimi financiar i administratës së prokurorive të niveleve të tjera, pranë sistemit gjyqësor, barazohet me punonjësit e administratës të sistemit gjyqësor, pranë së cilës funksionon prokuroria.”.

Neni 32

Pas nenit 58 shtohen nenet 58/a e 58/b me këtë përmbajtje:

“Neni 58/a

Në nenet 3, 9, 13 e në vijim të ligjit, fjalët “Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm” zëvendësohen me fjalët “Prokuroria e Përgjithshme”.

Neni 58/b **Dispozitë kalimtare**

Deri në fillimin e funksionimit të sistemit të vlerësimit të punës së prokurorit dhe kryerjen e vlerësimit dy herë, për efekt të ngritjes në detyrë dhe të karrierës, Prokurori i Përgjithshëm cakton procedura dhe kritere specifike për vlerësimin e aftësive profesionale të prokurorëve.”.

Neni 33

Në nenin 59 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çështjet e parashikuara në nenet 9 pikat 2 e 3, 10 pika 4, 12, 13, 14, 15, 20 pika 4, 22 pika 3, 27/c pika 1 shkronja “c”, 39 pika 2, 40, 41, 42 pika 10, 43 pika 3, 45, 49, 50, 51 e 58/b të këtij ligji rregullohen me akte nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm.”.

b) Në pikën 3 numri “36” shfuqizohet.

Neni 34

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6009, datë 15.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr.10 052, datë 29.12.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8116, DATË 29.3.1996 “KODI I
PROCEDURËS CIVILE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.”.

Neni 2

Në nenin 35 shkronjat “a” e “b”, fjalët “10 milionë lekë” zëvendësohen me fjalët “20 milionë lekë vetëm nëse një nga palët e kërkon në seancë përgatitore, sipas nenit 158/a të këtij Kodi.”.

Neni 3

Në nenin 73, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kryetari i gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit.”.

Neni 4

Neni 133 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 133

Kur marrësit nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, ose nuk ka zgjedhur një banesë, apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij, sipas nenit 131 të këtij Kodi, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit, ku do të gjykohet mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit, ku ka pasur vendbanimin e fundit.”.

Neni 5

Pas nenit 141 shtohet neni 141/a me këtë përmbajtje:

“Neni 141/a

Kur njoftimi për personat juridikë, sipas nenit 141 të këtij Kodi, nuk është i mundur, ky njoftim bëhet nëpërmjet afishimit të tij pranë adresës së regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.”.

Neni 6

Pas nenit 144 shtohet neni 144/a me këtë përmbajtje:

“Neni 144/a

Rregullat e parashikuara në këtë kre për njoftimet zbatohen nga përbaruesit gjyqësorë.”.

Neni 7

Në nenin 152, në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Gjatë shqyrtimit të kërkesës thirret edhe pala tjetër.”.

Neni 8

Në nenin 158/a bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Gjyqtari cakton, për çdo çështje, seancën përgatitore, ku thirren palët ose personi i tretë, për të përcaktuar natyrën e mosmarrëveshjes dhe kërkon prej tyre shpjegimet e nevojshme, si dhe përcaktimin e provave për vërtetimin e pretendimeve e të prapësimeve të tyre. Gjyqtari, me vendim, kryen këto veprime.”.

2. Paragrafi i katërt shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 161, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) në rast se gjykimi ka filluar dhe paditësi vëren se kërkitimi i tij shtrihet edhe ndaj një personi tjetër, atëherë mund ta shtrijë kërkimin edhe ndaj këtij të fundit, duke e thirrur si të paditur.”.

Neni 10

Në nenin 202 paragrafi i parë, pas fjalës “gjykata” shtohen fjalët “brenda 5 ditëve”.

Neni 11

Në nenin 232, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Gjithashtu, nuk lejohet të provohet me dëshmitarë marrëveshja e palëve për ndryshimin e kontratës ose shuarja, me anë të pagimit ose të faljes së detyrimeve në të holla, që rrjedhin nga një kontratë e bërë me dokument.”.

Neni 12

Pas nenit 485 shtohet neni 485/a me këtë përmbajtje:

“Neni 485/a

Pasojat kur prishet vendimi i padrejtë, i cili është ekzekutuar tërësisht ose pjesërisht

Kur vendimi i ri, që jepet pas prishjes, është i ndryshëm nga vendimi i parë, i cili është ekzekutuar, tërësisht ose pjesërisht, personi që ka përfutur detyrohet t'i kthejë të gjitha përfitimet e marra nga ekzekutimi i vendimit.”.

Neni 13

Në nenin 494, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) kur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”.

Neni 14

Në nenin 495 fjalët “nenin 96” zëvendësohen me fjalët “nenin 290”.

Neni 15

Në nenin 510, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;”.

Neni 16

Në nenin 511 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalja e dytë e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:

“Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit, i cili jepet:”.

2. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Nuk lëshohet urdhri i ekzekutimit për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjokat e dhëna nga gjykata, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga zyra e përbarimit, pas njoftimit të vendimit.”.

Neni 17

Neni 515 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 515

Vënia në ekzekutim

Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit.

Kreditori, përveç kërkesës për ekzekutim, duhet të paraqesë:

a) titullin ekzekutiv (origjinal ose i noterizuar);

b) urdhrin e ekzekutimit (origjinal);

c) pagesën e tarifës së vënies në ekzekutim;

ç) sipas rastit, prokurën e personit, që përfaqëson palën kreditore.

Kur nuk plotësohen në rregull dokumentet e mësipërme për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit, përbaruesi i lë kërkuarit një afat 5-ditor për plotësimin e mangësive. Kur kërkuari nuk plotëson këto mangësi brenda afatit të caktuar, dokumentacioni i kthehet atij. Kur mangësitë janë shmangur në afatin e caktuar, kërkesa për vënien në ekzekutim quhet e regjistruar nga data që është paraqitur pranë përbaruesit gjyqësor.

Vënia në ekzekutim e urdhrin të ekzekutimit bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të

kërkesës së kreditorit.

Vendimi i gjykatës për masën e sigurimit të padisë dhe gjrobat e gjykatës vihen në ekzekutim brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes për ekzekutim.

Tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrit ekzekutiv nuk parapaguhet në raste të parashikuara me ligj apo akte të tjera normative.”.

Neni 18

Në fund të nenit 516 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ky nen nuk zbatohet për personat, përmbaruesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbarimor gjyqësor, të organizuar mbi baza private.”.

Neni 19

Pas nenit 516 shtohet neni 516/a me këtë përmbajtje:

“Neni 516/a

Në çastin e fillimit të procedurës së ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor, në bazë të nenit 515 të këtij ligji, duhet të regjistrojë, në regjistrin qendror pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo kërkesë. Çdo përmbarues gjyqësor është i detyruar të njihet me të dhënat e regjistrit.

Nëse me fillimin e procedurës me objekt “Ekzekutim detyrimesh në të holla” përmbaruesi gjyqësor, nga të dhënat e marra nga regjistri qendror, vëren se kreditorë të tjerë janë në procedurë ekzekutimi ndaj të njëjtit debitor, me të njëjtin objekt, atëherë pezullon procedurën e nisur dhe drejton kreditorin e tij te përmbaruesi gjyqësor, i cili ka regjistruar i pari kërkesën për ekzekutim.

Në këtë rast, përmbaruesi gjyqësor, që ka regjistruar i pari kërkesën, vijon procedurën e ekzekutimit, në përputhje edhe me nenin 534 e në vijim të këtij Kodi.

Me pezullimin e procedurës së ekzekutimit, tarifa e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, së bashku me dokumentacionin, i kthehen kreditorit.

Ky nen nuk zbatohet kur në cilësinë e palës debitore është shteti.”.

Neni 20

Në nenin 517 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Me marrjen e lajmërimit për ekzekutim vullnetar, debitori është i detyruar të deklarojë, me shkrim, gjendjen e tij pasurore, si dhe sendet ose kredi që persona të tretë i detyrohen, nëse kjo kërkohet nga përmbaruesi gjyqësor.”.

2. Në paragrafin e dytë, pas fjalëve “rrethanave të tjera të çështjes” shtohen fjalët “pasi dëgjon edhe kreditorin”.

Në fjalinë e fundit të këtij paragrafi, pas fjalëve “Vendimi jepet në seancë gjyqësore” shtohen fjalët “brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.”.

Neni 21

Në nenin 522, pas fjalëve “për këtë rrethanë” shtohen fjalët “brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së përmbaruesit gjyqësor”.

Neni 22

Neni 523 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 523

Detyrimi për bashkëpunim

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të çelet banesa ose ndonjë ndërtesë tjetër e debitorit, pa praninë e tij ose të një personi madhor të familjes së tij, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, detyrohet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i njësisë së qeverisjes vendore. Në çdo rast, përmbaruesi gjyqësor kërkon edhe pjesëmarrjen e dy dëshmitarëve të tjerë.

Në rast nevoje, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, Policia e Rendit detyrohet ta mbështesë atë gjatë procedurave të ekzekutimit.

Kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të prishet objekti, të lirohet trualli, të pezullohen punimet, me kërkesë të përmbaruesit gjyqësor, inspektorati ndërtimor pranë pushtetit vendor dhe Inspektorati Kombëtar detyrohen të mbështesin përmbaruesin gjyqësor gjatë procedurave të ekzekutimit.

Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt “Takim dhe kujdestari fëmije”, përmbaruesi gjyqësor kërkon asistencën e psikologut, kur ky i fundit është i detyruar në bazë të ligjit për bashkëpunim.”.

Neni 23

Neni 525 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 525

Tarifat e përcaktuara për ekzekutimin e urdhrit ekzekutiv paguhen fillimisht nga kreditori dhe pas përfundimit të procedurës së ekzekutimit i ngarkohen debitorit. Shpenzimet e tjera gjatë procedurës së ekzekutimit paguhen nga pala, që i ka shkaktuar ato.”.

Neni 24

Në fund të nenit 528 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Me kërkesë të debitorit, sekuestroja mund të vihet, përveç pasurive të rënduara me peng dhe hipotekë, edhe mbi një pasuri tjetër të tij, të ndryshme nga ajo që ka treguar kreditori, kur përmbaruesi gjyqësor çmon se ajo plotëson kërkesën e kreditorit.”.

Neni 25

Në nenin 529, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.”.

Neni 26

1. Titulli i nenit 532 bëhet “Llogaria në bankë e zyrës së përmbarimit dhe e përmbaruesit gjyqësor”.

2. Në nenet 532 dhe 595, fjalët “llogaria e përmbaruesit gjyqësor” zëvendësohen me fjalët “llogari të zyrës së përmbarimit ose në llogari të përmbaruesit gjyqësor”.

Neni 27

Neni 533 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 533

Sekuestroja e pagës së debitorit

Pasi zbritet kontributi për sigurimet shoqërore dhe taksat mbi të ardhurat, përmbaruesi gjyqësor sekuestron pagën e debitorit, por pa cenuar minimumin jetik, të përcaktuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”.

Neni 28

Në fund të nenit 540 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:
“Përmbaruesi gjyqësor bën sekuestrimin e pasurive të luajtshme, mbi të cilat vendoset një etiketë e shërbimit të përmbarimit.”.

Neni 29

Neni 551 shfuqizohet.

Neni 30

Neni 552 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 552

Çmimi i sendit të sekuestruar caktohet nga përmbaruesi, në bashkëpunim me kreditorin dhe debitorin. Kur ka kundërshtime ndërmjet tyre, thirret një ekspert.”.

Neni 31

Në nenin 553 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli bëhet “Shitja e lirë e sendit”.
2. Paragrafi i dytë dhe i tretë shfuqizohen.
3. Paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Në qoftë se brenda 2 muajve sendi nuk shitet në shitje të lirë, përmbaruesi gjyqësor, duke marrë edhe pëlqimin e palëve, vendos nëse duhet të vazhdojë me shitjen e lirë edhe për 30 ditë të tjera apo të kalojë në procedurë ankandi.”.

Neni 32

Neni 554 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 554

Përmbaruesi gjyqësor, pasi njofton palët se sendi, për shkak të natyrës ose të gjendjes, nuk mund të pranohet në shitje të lirë, organizon shitjen me ankand të sendit, sipas çmimit të përcaktuar në nenin 552 të këtij Kodi.”.

Neni 33

Në fillim të nenit 555 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Çmimi fillestar i ankandit të parë është 80 për qind e çmimit të caktuar sipas nenit 552 të këtij ligji.”.

Neni 34

Neni 557 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 557

Ankandi i dytë

Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri, jo më të ulët se 30 për qind të çmimit fillestar, të caktuar në ankandin e parë dhe cakton një ankand të dytë për shitjen e sendit.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, përmbaruesi i propozon në fillim kreditorit, që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi heq sekuestron mbi këtë send, duke ia kthyer atë

debitorit dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të tij.”.

Neni 35

Në nenin 560 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Akti i përmbaruesit gjyqësor regjistrohet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tij.”.

2. Në fjalinë e fundit fjala “detyrimisht” hiqet.

Neni 36

Neni 564 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 564

Nëse kreditori dhe debitori, brenda një jave, nuk arrijnë një marrëveshje për vlerën e sendit, mbi të cilin është vendosur sekuestroja, përmbaruesi gjyqësor, brenda 15 ditëve, përcakton me vendim vlerën e tij, bazuar në aktin e ekspertimit, të paraqitur nga një ekspert i licencuar dhe në vlerën reale të pasurisë në treg, në çastin e vënies së sekuestros mbi të.

Përmbaruesi gjyqësor, brenda 10 ditëve nga data e caktimit të vlerës, njofton kreditorin dhe debitorin për çmimin e caktuar. Kundër vendimit të përmbaruesit palët mund të bëjnë ankim të veçantë.”.

Neni 37

Në nenin 568 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e parë, pas fjalëve “sendi i paluajtshëm” shtohen fjalët “gjykatë, komunë, bashki, njësitë bashkiake dhe në një vend apo vende të tjera publike, që ai i çmon të përshtatshme”.

2. Pas paragrafit të dytë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Çmimi fillestar në ankand është 80 për qind i çmimit të përcaktuar, sipas nenit 564 të këtij ligji.”.

Neni 38

Në nenin 569, pas fjalëve “në zyrën e përmbarimit” shtohen fjalët “ose në një vend tjetër publik, nëse është i përshtatshëm për zhvillimin e ankandit”.

Neni 39

Në nenin 573, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Rregullat e hollësishme për zhvillimin e ankandit përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 40

Në nenin 574 paragrafi i parë, fjalët “5 ditë” zëvendësohen me fjalët “15 ditë”.

Neni 41

Në nenin 575 fjalia e parë, pas fjalëve “përmbaruesi gjyqësor” shtohen fjalët “brenda 10 ditëve nga pagimi i çmimit të sendit.”.

Neni 42

Në nenin 577, paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Në rast se në ankandin e parë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë, brenda 10 ditëve nga përfundimi i tij, përmbaruesi gjyqësor përcakton çmimin e ri të sendit, jo më të ulët se 20 për qind të çmimit fillestar të caktuar në ankandin e parë. Ankandi i dytë për shitjen e sendit zhvillohet jo më vonë se 15 ditë nga data e caktimit të çmimit të ri.

Në rast se në ankandin e dytë nuk është paraqitur asnjë ofertues, atëherë përmbaruesi i propozon në fillim kreditorit që, kundrejt kredisë, të marrë sendin me çmimin e ankandit të dytë. Në rast se kreditori nuk pranon ta marrë sendin, përmbaruesi gjyqësor heq sekuestron mbi sendin e sekuestruar dhe vijon procedurat përmbarimore mbi pasuri të tjera të debitorit.”.

Neni 43

Neni 581 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 581

Deklarimi i pasurive të debitorit

Përpara se të vihet sekuestroja, përmbaruesi gjyqësor sigurohet për ekzistencën e kredive të debitorit dhe të sendeve, që personat e tretë i detyrohen atij.

Për këtë përmbaruesi gjyqësor njofton me shkresë personin e tretë dhe debitorin. Me marrjen e lajmërimit, pala debitore duhet të deklarojë pranë përmbaruesit gjyqësor se informacioni i paraqitur, për pasuritë e tij/saj apo të lëna në posedim personave të tretë, është i saktë e i plotë. Me marrjen e lajmërimit të sekuestrimit, personi i tretë ndalohet t’ia dorëzojë debitorit kredinë dhe sendet e tij.

Kur debitori është person juridik, deklarimi i pasurisë mund të bëhet nga një anëtar i organit drejtues, që, sipas ligjit ose statutit, ka të drejtën e përfaqësimit kundrejt të tretëve ose, në rastin e procedurave të shpërndarjes apo të falimentimit të personit juridik, mund të bëhet nga likuidatori apo administratori i falimentimit.

Ndaj debitorit, i cili jep deklarim të rremë, zbatohet neni 320 i Kodit Penal.”.

Neni 44

Në nenin 589, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Këshilli i Ministrave nxjerr udhëzim për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit.”.

Neni 45

Në nenin 593 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë shfuqizohet.
2. Në paragrafin e dytë fjalët “Kur ky nuk gjendet ose kur banka nuk ka gjendje për debitorin” hiqen.

Neni 46

Neni 596 shfuqizohet.

Neni 47

Pas nenit 601 shtohet neni 601/a me këtë përmbajtje:

“Neni 601/a

Sendet e luajtshme, që ndodhen brenda sendit të paluajtshëm, të vënë në posedim, sipas nenit

602 të këtij Kodi, duhet të zhvendosen në përgjegjësinë e përmbaruesit dhe t'i dorëzohen debitorit ose familjarëve të tij menjëherë. Në rast se debitori ose familjarët e tij nuk janë të pranishëm gjatë lirimit, përmbaruesi mund t'i magazinon pasuritë e luajtshme në:

- a) mjedisin e liruar, në marrëveshje me kreditorin, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;
- b) në mjediset, që disponon shërbimi përmbarimor, për ruajtjen e sendeve, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;
- c) në një vend neutral, ku sendet e luajtshme mund të ruhen në mënyrë të sigurt, për një periudhë kohe prej 2 muajsh;
- ç) në rezervat e shtetit, sipas rregullave në fuqi për ruajtjen e sendeve.

Për magazinimin e sendeve, sipas shkronjave “b” dhe “c” të këtij neni, shpenzimet paguhen nga debitori në çastin e marrjes në dorëzim të sendeve.

Nëse brenda 2 muajve nga lirimi, debitori nuk i kërkon sendet e tij të luajtshme, sipas shkronjave të mësipërme, apo nuk paguan të gjitha shpenzimet e lirimit dhe të magazinimit, sipas shkronjave “b” dhe “c” të këtij neni, sendet e luajtshme, të sekuestrueshme, do të shiten nga përmbaruesi gjyqësor, sipas dispozitave të pjesës IV të kreut II të këtij Kodi. Përmbaruesi, pasi zbret nga shuma e përfituar nga shitja me ankand të gjitha shpenzimet për lirim dhe magazinimin e sendeve të debitorit, derdh pjesën që mbetet në një llogari bankare, në emër të debitorit. Sendet e pasekuestrueshme i kthehen debitorit, pavarësisht vendit se ku ruhen, pa i kërkuar atij që të paguajë shpenzimet.

Sendet e luajtshme, të ndodhura brenda sendit të paluajtshëm, që nuk mund të shiten dhe nuk kërkojnë nga debitori, asgjësohen apo i kalojnë institucioneve shtetërore ose enteve publike shtetërore kalim kapital.”.

Neni 48

Në nenin 609, paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Në këto raste, gjykata shqyrton çështjen brenda 5 ditëve dhe mund të vendosë pezullimin e vendimit me ose pa garanci. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.”.

Neni 49

Në nenin 610 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e dytë, pas fjalës “shqyrtohet” shtohen fjalët “brenda 20 ditëve”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kundër veprimeve të personave, përmbaruesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbarimor gjyqësor të organizuar mbi baza private, pala debitore mund të paraqesë ankim në gjykatën, ku ekzekutohet titulli ekzekutiv, brenda 5 ditëve nga data e kryerjes së veprimit.”.

3. Në paragrafin e fundit, fjalët “me cilësinë e personit të tretë” zëvendësohen me fjalët “me cilësinë e palës së paditur”.

Neni 50

Në nenin 615 bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” e “dh” me këtë përmbajtje:

“d) kur përmbaruesi gjyqësor, vetë ose me kujdesin e kreditorit, nuk gjen pasuri të debitorit, brenda 6 muajve nga fillimi i ekzekutimit;

dh) kur kreditori nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor.”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Pas rënies së masës së pezullimit, ekzekutimi vazhdon nga veprimi procedural i mbetur në çastin e pezullimit.”.

Neni 51

Në nenin 616, shkronja “d” shfuqizohet.

Neni 52

Në nenin 617, fjalia e parë e paragrafit të tretë ndryshohet si më poshtë:

“Kur vendimi i pushimit të ekzekutimit merr formën e prerë, përmbaruesi gjyqësor e heq sekuestron e vënë mbi sendet e luajtshme ose të paluajtshme dhe në rastin e parashikuar nga shkronja “b” e nenit 616 të këtij Kodi, i kthen urdhrin e ekzekutimit kreditorit, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë të re për ekzekutim brenda kohës së parashkrimit.”.

Neni 53

Dispozitë kalimtare

Çështjet që janë në procedurë ekzekutimi në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të ekzekutohen sipas procedurave ligjore të mëparshme, derisa ekzekutimi i urdhrit ekzekutiv të jetë pezulluar, pushuar ose të ketë përfunduar.

Neni 54

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6010, datë 15.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.10 053, datë 29.12.2008

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7961, DATË 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

Mbrojtja për punonjësit që denoncojnë korrupsionin

1. Çdo masë ose sanksion administrativ i pajustificuar, që është marrë ndaj punonjësve, të cilët kanë arsye të dyshojnë për korrupsion e që këtë dyshim ua paraqesin personave përgjegjës ose autoriteteve kompetente, është i pavlefshëm.

2. Kundër vendimit të dhënë në mënyrë të pajustificuar për shkakun e mësipërm, punonjësi ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

3. Raportimi i fakteve, që kanë lidhje me korrupsionin, nuk përbën shkelje të detyrimit të

sekretit profesional.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6011, datë 15.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 054, datë 29.12.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.3.1995 “KODI I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 pikat 1 e 2 shkronja “d” dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 59 pika 1, pas numrit 119 shtohet numri 119/b.

Neni 2

Pas nenit 191 shtohet neni 191/a me këtë përmbajtje:

“Neni 191/a

Detyrimi për paraqitjen e të dhënave kompjuterike

1. Gjykata, në rastin e procedimeve për vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit, me kërkesë të prokurorit ose të të dëmtuarit akuzues, urdhëron mbajtësin ose kontrolluesin të dorëzojnë të dhënat kompjuterike të memorizuara në një sistem kompjuterik apo në një mjet tjetër memorizimi.

2. Gjykata, në këto procedime, urdhëron edhe dhënësin e shërbimit për dorëzimin e çdo informacioni për abonentët e pajtuar, për shërbimet e ofruara nga dhënësi.

3. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nga vonesa mund t'u vijë një dëm i rëndë hetimeve, prokurori vendos, me akt të motivuar, detyrimin për paraqitjen e të dhënave kompjuterike, të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni dhe njofton menjëherë gjykatën. Gjykata vlerëson vendimin e prokurorit brenda 48 orëve nga njoftimi.”.

Neni 3

Pas nenit 208 shtohet neni 208/a me këtë përmbajtje:

“Neni 208/a

Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike

1. Në rastin e procedimeve për veprat penale në fushën e teknologjisë së informacionit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, vendos sekuestrimin e të dhënave dhe të sistemeve kompjuterike. Në këtë vendim, gjykata përcakton të drejtën për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik.

2. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të menduar se të dhënat e kërkuara kompjuterike janë memorizuar në një sistem tjetër kompjuterik apo në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej ose janë të disponueshme nga sistemi kompjuterik fillestar, që kontrollohet, gjykata, me kërkesë të prokurorit, urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuterik.

3. Në zbatim të vendimit të gjykatës, prokuroria ose oficeri i policisë gjyqësore, i deleguar nga prokurori, merr masa:

a) për të ndaluar kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose për të siguruar sistemin kompjuterik, vetëm të një pjese të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhënash;

b) për të nxjerrë dhe marrë kopje të të dhënave kompjuterike;

c) për të penguar hyrjen në të dhënat kompjuterike, ose për t'i hequr këto të dhëna nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje;

ç) për të siguruar paprekshmërinë e të dhënave përkatëse, të memorizuara.

4. Për zbatimin e këtyre veprimeve, prokurori mund të urdhërojë thirrjen e një eksperti, i cili ka njohuri rreth funksionimit të sistemeve kompjuterike apo të masave të zbatuara për mbrojtjen e të dhënave kompjuterike në të. Eksperti i thirrur nuk mund të refuzojë detyrën pa shkaqe të arsyeshme.”.

Neni 4

Pas nenit 299 shtohen nenet 299/a e 299/b me këtë përmbajtje:

“Neni 299/a

Ruajtja e përshpejtuar dhe mirëmbajtja e të dhënave kompjuterike

1. Prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e përshpejtuar të të dhënave kompjuterike të caktuara, duke përfshirë të dhënat e trafikut, kur ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se të dhënat mund të humbasin, dëmtohen ose ndryshohen.

2. Në rastin kur të dhënat kompjuterike janë në zotërim ose në kontroll të një personi, prokurori mund ta urdhërojë këtë person t'i ruajë dhe t'i mirëmbajë këto të dhëna kompjuterike, për një periudhë deri në 90 ditë, me qëllim zbulimin dhe nxjerrjen e tyre. Ky afat, për shkaqe të arsyeshme, mund të zgjatet vetëm një herë.

3. Personi i ngarkuar për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave kompjuterike detyrohet të mbajë sekret procedurat dhe veprimet e kryera, sipas pikës 2 të këtij neni, deri në përfundim të hetimeve.

Neni 299/b

Ruajtja e përshpejtuar dhe zbulimi i pjesshëm i të dhënave kompjuterike

Personi i ngarkuar me ruajtjen e përshpejtuar të të dhënave të trafikut detyrohet të marrë të gjitha masat e nevojshme, për të garantuar se të dhënat e ruajtura janë të vlefshme, pavarësisht nëse një apo më tepër dhënës shërbimesh kanë qenë të përfshirë në transmetimin e komunikimit, si dhe t'i sigurojë prokurorisë ose oficerit të policisë gjyqësore, të autorizuar, zbulimin e një sasive të mjaftueshme të të dhënave të trafikut, në mënyrë që të mundësohet identifikimi i dhënës të shërbimit dhe shtegu, nëpërmjet të cilit komunikimi është transmetuar.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6012, datë 15.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 15.1.2009
Doli nga shtypi më 16.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 48 lekë